



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute Kosovski
Institut Pravde

Drejtësia civile në Kosovë, ligji VS praktika



Prishtinë, nëntor 2019

Autor: Driton Nocaj

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Yll Zekaj dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Nëntor 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Metodologjia.....	7
3. Korniza ligjore	8
3.1. Përgjegjësia ligjore e Këshillit Gjyqësor për sigurimin e një sistemi të drejtë dhe objektiv.....	13
4. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës	13
4.1. Përformaca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatat Themelore.....	17
4.2. Ngarkesa me lëndë sipas llojit të kontesteve dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve civile	21
5. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatës së Apelit	24
5.1. Performanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatën e Apelit.....	27
6. Trajtimi i rasteve civile në Gjykatën Supreme	30
7. Gjetjet e monitorimit të IKD-së në trajtimin e rasteve civile	31
7.1. Dështimi i sistemit gjyqësor në sigurimin e mjetit efikas juridik në rastet civile	32
7.2. “Ping-Pongu” i GjTh-ve dhe GjA me rastet civile.....	34
8. Annex 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike civile.....	36
9. Rekomandimet:	51

1. Përmbledhje ekzekutive

Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës ka afirmuar standardet më të larta në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe proceseve gjyqësore të drejta. Mbi bazën e dispozitave kushtetuese, Republika e Kosovës tanimë ka ndërtuar kornizë ligjore e cila në letër garanton një proces të drejtë dhe në kohë të arsyeshme.

Përkundër kësaj kornize ligjore sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës vazhdon të përballet me sfida të vazhdueshme, të cilat nuk adresohen vit pas viti, sfida këto të lidhura ekskluzivisht me zbatimin e ligjeve tanimë të miratuara. Këto sfida shfaqen pothuajse në të gjitha fushat e sistemit gjyqësor, rrjedhimisht edhe në rastet civile. IKD gjatë procesit të monitorimit gjen se afatet ligjore dhe procedurat nuk respektohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Përderisa, sistemi gjyqësor apo gjykatës të caktuar përdorin standarde të dyfishta për zyrtarë publikë kur paraqesin padi pranë organeve gjyqësore, duke i privilegjuar ata, duke i trajtuar lëndët e tyre brenda afateve kohore shumë të shkurta, përderisa për qytetarë të thjeshtë trajtimi i lëndëve zvarritet për vite dhe dekada të tëra.

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka hyrë në vitin e gjashtë të monitorimit të punës së Këshillave, Gjykatave dhe Prokurorive. Ky raport fokusohet në trajtimin e rasteve civile nga ana e sistemit gjyqësor gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, gjatë së cilës periudhë kohore IKD ka monitoruar gjithsej 1884 seanca të natyrës civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Sa i përket trajtimit të lëndëve civile nga Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës, IKD në këtë raport gjenë se ndonëse ka pasur rritje të numrit të gjyqtarëve, numri i lëndëve të zgjidhura ka rënë vit pas viti. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, numri gjyqtarëve në divizionet civile është rritur për 8%, përkatësisht ka pasur 6 gjyqtarë më shumë. Në këtë drejtim, përderisa në vitin 2016 Gjykatat Themelore kanë zgjidhur gjithsej 17.544 lëndë civile, ky numër ka rënë për 633 lëndë në vitin 2017 (16.911 lëndë të zgjidhura) dhe për 143 lëndë të tjera në vitin 2018 (16.768 lëndë të zgjidhura).

Lidhur me numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjykatat Themelore kanë zgjidhur gjithsej 166 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Numri prej 166 lëndëve të kryera më shumë se sa lëndët e pranuar nuk garanton në asnjë formë arritjen e një stabiliteti në kuptim të zvoglimit të lëndëve të cilat barten vit pas viti. Në fund të gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura ka qenë 44.047. Nëse shkohet me këtë tempo, përkatësisht që çdo gjashtë (6) muaj numri i lëndëve të pazgjidhura, të cilat barten vit pas viti të ulet nga 166 lëndë, nënkupton se sistemit të drejtësisë do t'i duhet plotë 132 vite në zgjidhjen e lëndëve në ccështjet civile, që nënkupton diçka objektivisht të paarritshme. Për këtë arsye, mënyra dhe metodologjia drejt zvoglimit të lëndëve të cilat barten vit pas viti, duhet të ndryshojë rrënjësisht.

Po ashtu, sipas mesatares, Gjyqtarët e Dizioneve Civile nuk kanë arritur të përmbushin normën vjetore të lëndëve, pasi përballë obligimit të tyre që në vit t'i kryejnë nga 329 lëndë, të njëjtit kanë kryer nga 182 lëndë, përkatësisht nga 147 lëndë më pak.

Në këtë drejtim, gjetjet flasin për nevojën e domosdoshme të angazhimit të KGJK-së në dy drejtime. E para KGJK, përmes mekanizmave të saj të ri-vlerësoj lidhur me numrin e lëndëve që një gjykatës mund të përfundoj brenda një muaji apo viti kalendarik si dhe sipas nevojës edhe rishikimin nga ana e KGJK-së të rregullores mbi normat orientuese. Pjesa, tjetër, është ngritja e llogaridhënies së gjykatësve para KGJK-së dhe mekanizmave të saj si Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjykatësve lidhur me performancën në nivelin e politikave të miratuara nga KGJK.

KGJK para publikut dhe qytetarëve duhet të ngritë llogaridhënien individuale të gjykatësve dhe të vet sistemit në trajtimin e lëndëve civile. Kjo më së miri, vërtetohet, me faktin se nëse secili prej 99 gjyqtarëve të divizioneve civile do ta arrinte normën vjetore të numrit të lëndëve të kryera, do të kishim gjithsej 32.571 lëndë të kryera, e jo 10.413 lëndë të kryera, siç ka qenë numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2018. Përballë numrit prej 10.247 lëndë të pranuar, numri i lëndëve të trashëguara vit pas viti do të binte edhe për 22.324 lëndë. Më 30 qershor 2019, numri i lëndëve të pazgjdhura në fund të periudhës raportuese ka qenë 44.047, që nënkupton se sikur të zbatohet norma, lëndët e pazgjdhura të cilat barten vit pas viti do të përfundonin për pak më shumë se dy vite, dhe sistemi gjyqësor do të arrinte stabilitetin në kuptim të ngarkesës së gjyqësorit me lëndë civile.

Në anën tjetër, nuk mohohet fakti se norma e përcaktuar nga KGJK është një normë orientuese. Por, nuk nënkuptohet se e njëjta është e pavlerë. Në këtë drejtim, përderisa KGJK ka një rregullore, e cila përcakton normat orientuese për gjyqtarë, të cilën normë gjyqtarët nuk e arrijnë, është e pakuptimt që sistemi gjyqësor të kërkojë rritjen e numrit të gjyqtarëve. Për këtë arsye, KGJK duhet të rianalizojë në detaje dhe të jap përkushtim maksimal për ndryshimin e rregullores mbi normat orientuese, marrë për bazë faktin se numri i lëndëve civile të cilat barten vit pas viti, është problemi kryesor i sistemit gjyqësor, sa i përket drejtësisë civile. Pas këtij rianalizimi dhe mbajtjes përgjegjës të gjyqtarëve, të cilët nuk e arrijnë normën, atëherë gjyqësori mund të angazhohet që të kërkojë rritjen e numrit të gjyqtarëve në divizionet civile.

Sa i përket lëndëve civile në Gjykatën e Apelit, analiza e IKD-së në këtë raport gjenë se ngritja e numrit të gjyqtarëve në divizionin civil të kësaj Gjykate në vitin 2019 ka ndikuar pozitivisht në uljen e numrit të lëndëve të pazgjdhura të cilat barten vit pas viti. Në këtë mënyrë, ndonëse ende nuk bëhet fjalë për stabilitet të lëndëve civile në këtë Gjykatë, IKD gjenë se Gjykata e Apelit tanimë ka hyrë në binarët drejt stabilizimit të numrit të lëndëve të pazgjdhura të cilat barten vit pas viti.

Në anën tjetër, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës tanimë e ka arritur këtë stabilitet.

Sa i përket trajtimit të rasteve civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, IKD gjenë se ky sistem ka dështuar në ofrimin e një mjeti efikas juridik për këto raste. Por, sa i përket mjetit efikas juridik, kjo nuk ndodh kështu me të gjitha rastet civile, pasi që kemi një qasje selektive nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, përderisa kemi raste të cilat as pas dy dekadave nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ka raste të tjera të cilat përfundojnë brenda 35 ditëve.

Po ashtu, në rastet civile dukuria e kthimit të lëndëve në rigjykim nga GjA është duke u rritur vit pas viti, çfarë po ndikon në krijimin e “ping-pongut” me lëndë në mes instancave të ndryshme brenda sistemit gjyqësor. Në këtë mënyrë, kjo qasje e GjA përpos që zvarrit qytetarët në realizimin e të drejtave të tyre përmes rrugëve gjyqësore, edhe ngarkon sistemin gjyqësor me numër të lëndëve.

2. Metodologjia

IKD me qëllim të përpilimit të një raporti sa më gjithëpërfshirës dhe analitik në lidhje me trajtimin e rasteve civile nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij raporti, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të KGJK-së, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga institucionet gjyqësore përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përpos këtyre dokumenteve, përpilimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së gjyqtarëve në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD përditëson për publikun Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e rasteve civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës, përfshirë këtu edhe degët e Gjykatave Themelore. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve më karakteristike civile në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket rasteve civile në sistemin gjyqësor, IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të Departamenteve të Përgjithshme – Divizioneve Civile (Tutje: Divizionet Civile), trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën individuale të gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si duhet të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti në trajtimin e këtyre rasteve.

Sa i përket rasteve të natyrës civile, IKD-ja gjatë vitit 2018 dhe gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2019 ka monitoruar gjithsej 1884 seanca të natyrës civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Në këtë raport, IKD ka analizuar gjetjet kryesore nga monitorimi sistematik i rasteve civile në sistemin gjyqësor, derisa në annexin 1 të këtij raporti do të trajtohen edhe raste të përzgjedhura të proceseve gjyqësore civile.

3. Korniza ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta njihet si akti më i lartë juridik i vendit, në harmoni me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore. Në kuadër të Kushtetutës janë materializuar edhe parimet që ndërtojnë drejtësinë në rastet juridiko-civile.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat ose interesat e qytetarëve të saj. Kushtetuta gjithashtu ka vendosur si kriter se mjetet juridike, përveç që janë në dispozicion, gjithashtu duhet të jenë efektive. Kjo Kushtetutë parasheh në mënyrë decidive të drejtën në mjete efektive: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*¹.

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar se *“E drejta e pronës është e garantuar”*². Sa i përket rregullimit të llojeve të pronës, këtë çështje Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka lënë në kompetencë të ligjit³.

Republika e Kosovës në faqen e parë të Kushtetutës së saj ka paraparë se autoriteti i saj shtetëror do të ushtrohet dhe bazohet në respektim të të drejtave të njeriut, sidomos atyre të drejtave dhe lirive themelore të pranuar ndërkombëtarisht.

Duke u nisur nga parimi i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore e që është parim bazë sipas të cilat Republika e Kosovës e ushtron pushtetin e saj shtetëror, e njëjta ka inkorporuar në sistemin kushtetues dokumente të rëndësishme ndërkombëtare me qëllim të respektimit të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndër to është edhe KEDNj, e cila ka epërsi ndaj ligjeve tjera të Republikës së Kosovës në rast të konfliktit ligjor.⁴ Të gjitha institucionet shtetërore në Republikën e Kosovës janë të detyruara përmes Kushtetutës që gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të respektojnë, garantojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

² Po aty, neni 46.

³ Po aty, neni 121.

⁴ *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”*. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 22.

Neni 6 i KEDNj-së përcakton se “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet **drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm** nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.

Ky përcaktim i kësaj konvente, i cili garanton që gjykimi të jetë i zhvilluar brenda një kohe të arsyeshme, është inkorporuar edhe në vetë Kushtetutën e Kosovës, e cila përcakton se “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj, e cila dispozitë rumbollaksion të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm⁵”.

Sa i përket rasteve gjyqësore të natyrës civile, të njohura ndryshe si kontestet juridiko-civile, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat përcaktohen organet kompetente gjyqësore për trajtimin e këtyre lëndëve. Duke ruajtur strukturën e njejtë organizative sa i përket këtyre rasteve, ky ligj është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, “Gjykatat - Sistemi i Gjykatave i Republikës së Kosovës përbëhet nga: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme”⁶, ndërsa “degët themelohen brenda territorit të një Gjykate Themelore”⁷.

Ky ligj përcakton se “Departamenti i Përgjithshëm, që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore”⁸ dhe se “Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë e një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore”⁹.

Në kuadër të Departamenti të Përgjithshëm funksionojnë edhe tri (3) divizione, përkatësisht Divizioni Penal, Divizioni për Kundërvajtje dhe Divizioni Civil. Ky i fundit, është objekt i trajtimit të këtij raporti.

Po ashtu, ky departament funksionon në këtë mënyrë edhe në Gjykatën e Apelit, derisa në Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, gjyqtarët nuk janë të ndarë në departamente sipas natyrës së lëndëve që trajtohen.

Sa i përket rasteve civile, sistemi juridik i Republikës së Kosovës ka një bazë ligjore pothuajse të konsoliduar, e cila në ligj garanton realizimin e të drejtave të qytetarëve në proceset gjyqësore të karakterit juridiko-civil. Në këtë drejtim, si ligje bazike për këto raste janë Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligji për Procedurën Kontestimore.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 31.2.

⁶ Ligji Nr.06/L-054 për Gjykatat. Neni 8.1.

⁷ Po aty. Neni 8.2.

⁸ Po aty. Neni 13.1.5.

⁹ Po aty. Neni 20.1.

Me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të rasteve në njërin anë dhe shkarkimit të Gjykatave në anën tjetër, në Republikën e Kosovës funksionojnë edhe profesionet e lira që japin kontribut në këtë aspekt, siç janë noteria, përmbaruesi privat dhe ndërmjetësuesi.

Siç u tha edhe më lartë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka inkorporuar tetë (8) instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të cilat janë të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës dhe po ashtu ka përcaktuar se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore duhet të interpretohen sipas standardeve të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Në këtë rast është e rëndësishme të theksohen disa vendime gjyqësore nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Fillimisht, sa i përket aspektit procedural gjyqësor, një ndër parimet kryesore të KEDNj-së është mjeti efektiv juridik. Në këtë kuptim, KEDNj përcakton se:

Neni 13:

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Sa i përket mjetit efektiv, në rastet *McFarlane v. Ireland* dhe *Riccardi Pizzati v. Italy*, GjEDNj ka nënvizuar se një mjet juridik është efektiv vetëm nëse është i arritshëm dhe meritohet,¹⁰ derisa në rastet *El -Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* dhe *Kudła kundër Polonisë*, kjo Gjykatë ka potencuar se efektshmëria e një mjeti juridik duhet të jetë e zbatueshme si në praktikë, ashtu edhe në rregullimin ligjor¹¹.

Ndërsa, në rastin *MIKULIC kundër KROACISË*, theksohet se "*Shtetet Kontraktuese duhet të organizojnë sistemet e tyre juridike në një mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të mund të garantojnë të drejtën e secilit për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet civile brenda një kohe të arsyeshme*".¹²

Kjo Gjykatë në rastin *Kreuz kundër POLONISË* ka theksuar se neni 6 i KEDNJ u siguron të gjithëve të drejtën për të paraqitur kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile pranë

¹⁰ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *McFarlane kundër Irlandës*. Aktgjykim. Strasburg. 10 shtator 2010. Paragrafi 114; Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Riccardi Pizzati kundër Italisë*. Aktgjykim. Strasburg. 29 mars 2006. Paragrafi 38.

¹¹ Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *El-Masri kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*. Aktgjykim. Strasburg. 13 dhjetor 2012. Paragrafi 255; Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Kudła kundër Polonisë*. Aktgjykim. Strasburg. 26 tetor 2000. Paragrafi 152.

¹² Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti *Mikulic kundër Kroacisë*. Aktgjykim. Strasburg. 4 shtator 2002. paragrafi 45.

një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, kjo dispozitë përmban të drejtën e qasjes si një parim që mundëson përfitim nga garancitë e mëtutjeshme të paraqitura në paragrafin 1 të nenit 6 të Konvetës.

Po ashtu, GjEDNJ në rastin Peceve kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë ka theksuar se autoritetet shtetërore e kanë për obligim pozitiv që të organizojnë një sistem efikas për zbatim të vendimeve në kuptimin ligjor dhe praktik dhe të sigurojnë që zbatimi i tyre të bëhet pa vonesa të panevojshme.

Neni 6 i KEDNJ kërkon që proceset të kryhen brenda “një afati të arsyeshëm”. Në kërkesën që gjykimi i çështjeve të bëhet brenda “një afati të arsyeshëm”, Gjykata e Strasburgut në rastin H kundër Francës vë theksin tek rëndësia e administrimit të drejtësisë pa vonesa, mund të kërcënonjë efektshmërinë dhe besueshmërinë e saj.

Gjykata Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Konveta Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, në kontekst të gjykimit në “kohë të arsyeshëm”, nuk ka përcaktuar në mënyrë specifike se sa mund të jetë një kohëzgjatje, e cila mund të çënojë të drejtën për gjykim në kohë të arsyeshme, por konstatimin e shkeljes së kësaj të drejte GEDNJ e merr në konsideratë dhe vlerëson duke u bazuar në rrethanat e rastit konkret.

Sipas GEDNJ vlerësimi i cënimit të procesit të rregullt gjyqësor, duke cënuar detyrimin e “kohës së arsyshme”, është i ndryshëm bazuar në rrethanat e rastit konkret. Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut arsyeshmëria e zgjatjes të procesit gjyqësor duhet të vlerësohet bazuar në kriteret e kompleksitetit të çështjes që është objekt shqyrtimi, sjelljen e palëve ndërgjyqëse si dhe sjelljen e autoritetit gjyqësor - në këtë rast gjykatës, e cila trajton çështjen civile si dhe kriterin tjetër se çfarë është rrezik për parashtruesin e kërkesës. Për të arritur një konkluzion se kemi të bëjmë me stërzgjatje të procedurave duhet të bëhet një analizë dhe vlerësim i kriterëve të lartëcekura bazuar në rrethanat e veçanta të çështjes civile. Kështu ka përcaktuar GjEDNJ në rastin Zimmerman k. Zvicrës dhe raste të tjera të kësaj natyre.

Vonesat të cilat vijnë si rezultat i grumbullimit afatgjatë të çështjeve të trashëguara si të pakryera në gjykata, kombinuar me mosmarrjen e masave për të korrigjuar situata të tilla, nga GjEDNJ janë konsideruar shkelje të KEDNJ-së, në rastin Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës.

Në rastin Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, GjEDNJ-ja ka gjetur përgjegjës shtetin për mosdhënien e një vendimi të formës së prerë dhe për kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore.

GjEDNJ duke vlerësuar sjelljen e gjykatave të rregullta ka gjetur se atyre u ishin dashur shtatë vite për të vendosur për titullin juridik të ankesve dhe atë në tri stade të procedurave civile ku sipas GjEDNJ, gjykata e rregullta kishin qenë të vetëdijshme për procedurat paralele dhe sikur këto të bashkoheshin do të ishte menaxhim më i mirë i drejtësisë.

Ndërsa në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GjKK) ende nuk ekziston ndonjë verdikt në të cilin është konstatuar shkelja e procesit të rregullt gjyqësor civil për stërzgjatjen e proceseve civile.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në vitin 2017 ka patur në shqyrtim një pretendim kushtetues të ngritur nga Qazim Bytyqi, i cili ishte ankuar për stërzgjatje të çështjes së tij civile nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS). Kërkuesi kishte theksuar se procedura prej gjashtë (6) vite e nëntë (9) muaj për kërkesën e tij për kompensimin e pagave në DhPGjS kishte shkelur garancinë kushtetuese për gjykim në kohë të arsyeshme. Argumenti kryesor referuar nga ana e DhPGjS-së ishte se çështja kontestimore ishte e ndërlikuar, kishte 98 ankues dhe numër të madh të dokumenteve, mbingarkesë të lëndëve civile në pritje, mungesë të stafit dhe rritje të vazhdueshme të ankesave nga qytetarët.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se kohëzgjatja e përgjithshme prej gjashtë (6) vite e nëntë (9) muaj e procedurave pranë Kolegjit të Specializuar dhe pranë Kolegjit të Apelit të DhPGjS, nuk mund të konsiderohet e paarsyeshme, duke marrë parasysh ndërlikueshmerinë e rastit, sjelljen e palëve dhe rrezikun për parashtruesit e kërkesës.

Po ashtu, në një rast tjetër të parashtruar nga një palë, GjKK ka gjetur shkelje të drejtave të njeriut, më konkretisht nenit 31 të Kushtetutës¹³ në lidhje me nenin 6 të KEDNJ, kur gjykata e Apelit ka marrë vendim që të pezullohet procedura civile e nisur nga parashtruesi Valdet Nikçi¹⁴.

¹³ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32* “[E Drejta për Mjete Juridike] Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

¹⁴ *Shënim: Ky rast trajtohet në detaje në annexin 1 të këtij raporti.*

3.1. Përgjegjësia ligjore e Këshillit Gjyqësor për sigurimin e një sistemi të drejtë dhe objektiv

Këshillit Gjyqësor i Kosovës (KGJK) është institucion kushtetutes, i cili ka për qëllim që sistemi gjyqësor i Kosovës të jetë i pavarur, profesional dhe i paanshëm. Përcaktimi i këtij detyrimi është i shprehur në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

KGJK është përgjegjës për sigurimin e vlerësimeve të rregullta periodike mbi ngarkesën e lëndëve të gjykatave ashtu që të sigurohet funksionimi efikas në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Më bazë të Ligjit mbi KGJK-në, ky institucion ka për mandat ligjor sigurimin dhe vlerësimin e rregullt periodik mbi ngarkesën e lëndëve, në mënyrë që të sigurohet funksionimi efikas i gjykatave. KGJK ka për kompetencë administrimin e gjyqësorit dhe inspektimin e tij, vendos kriteret për vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve.

KGJK po ashtu ka miratuar Planin Strategjik të Gjyqësorit për periudhën kohore 2014-2019, ku në objektivin strategjik 2.4.1 është përcaktuar se Këshilli Gjyqësor gjatë kësaj periudhe do të eliminojë dhe do t'i miratojë procedurat për t'iu shmangur grumbullimit të lëndëve në të ardhmen.

Ky Plan Strategjik përbëhet prej pesë shtyllave kryesore të cilat janë, krijimi i besimit dhe mbështetjes, avancimi i administrimit të drejtësisë, shtimi i qasjes në drejtësi dhe në shërbim për qytetarë, promovimi i kompetencës, i profesionalizmit dhe mirësjelljes, përmisimi i objekteve dhe teknologjisë së gjykatave.

4. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës


Me qëllim të pasqyrit sa më të saktë të punës ndër vite të Divizionit Civil të Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës, përfshirë selitë dhe degët e tyre, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që ky divizion ka pasur që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës në vitin 2016 kanë pasur në punë gjithsej 58,082 lëndë civile, ku 42560 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak ndërsa 15522 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2016, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë zgjidhur gjithsej 17544 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 40538 lëndë.

Sa i përket vitit 2017, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 58278 lëndë civile, ku 40538 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 17740 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2017, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë zgjidhur gjithsej 16911 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 41367 lëndë.

Në vitin 2018, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 60981 lëndë civile, ku 41372 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 19609 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2018, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë zgjidhur gjithsej 16768 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 44213 lëndë.

Gjashtë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, Gjykatat Themelore të Republikës së Kosovës kanë pasur në punë gjithsej 54460 lëndë, ku 44213 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 10247 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykatat Themelore kanë zgjidhur gjithsej 10413 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 44047 lëndë.



Grafika 1 - Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni civil gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

Nëse shikohen trendet e kryerjes së lëndëve civile në të gjitha GjTh-të që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019, atëherë vërehet se numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese vazhdimisht është rritur, përjashtimisht gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019 ku ka një ulje të lehtë. Në këtë drejtim, përderisa në fund të vitit 2016 kanë mbetur të pazgjidhura 40.538 lëndë, në vitin 2017 ky numër është për 829 lëndë, përkatësisht në 41.367 lëndë të pazgjidhura në fund të vitit 2017. I njëjti numër është rritur dukshëm në fund të vitit 2018, pasi gjatë këtij viti, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 është rritur edhe për 2.846 lëndë civile, përkatësisht kanë mbetur të pazgjidhura edhe 44.213 lëndë. Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese ka rënë për 166 lëndë civile, përkatësisht në 44.047 lëndë të pazgjidhura.

Në rritjen e këtij numri fillimisht ka ndikuar edhe numri i lëndëve civile të pranuar, i cili është rritur vit pas viti. Përderisa në vitin 2016 në të gjitha GjTh-të janë pranuar 15.522 lëndë, ky numër është rritur për 2.218 lëndë në vitin 2017 (17740 të pranuar) dhe edhe për 1.869 lëndë të tjera në vitin 2018 (19609 lëndë të pranuar).

Por, ndonëse ka pasur rritje të numrit të gjyqtarëve, numri i lëndëve të zgjidhura ka rënë vit pas viti. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, numri gjyqtarëve në divizionet civile është rritur për 8%, përkatësisht ka pasur 6 gjyqtarë më shumë.

Në këtë drejtim, përderisa në vitin 2016 Gjykatat Themelore kanë zgjidhur gjithsej 17.544 lëndë civile, ky numër ka rënë për 633 lëndë në vitin 2017 (16.911 lëndë të zgjidhura) dhe për 143 lëndë të tjera në vitin 2018 (16.768 lëndë të zgjidhura).

Bazuar në raportet zyrtare të KGJK-së, GjTh të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 kanë zgjidhur 16.768 lëndë civile, derisa kanë pranuar 19.690 lëndë. Në total, ky departament ka qenë i ngarkuar me gjithsej 60.981 lëndë.

Nga kjo statistikë vërehet se Gjyqtarët e divizioneve civile gjatë vitit 2018 nuk kanë arritur që të zgjidhin aq lëndë sa kanë pranuar, përkatësisht kanë zgjidhur 2.922 lëndë më pak. Në këtë rast, kjo shifër është ekuivalente me ngritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit.

Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjykatat Themelore kanë zgjidhur gjithsej 166 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar.

Numri prej 166 lëndëve të kryera më shumë se sa lëndët e pranuar nuk garanton në asnjë formë arritjen e një stabiliteti në kuptim të numrit të lëndëve, të cilat barten vit pas viti. Në fund të gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura ka qenë 44.047. Nëse shkohet me këtë dinamikë, përkatësisht që çdo gjashtë (6) muaj numri i lëndëve të pazgjidhura, të cilat barten vit pas viti të ulet nga 166 lëndë, nënkupton se sistemit të drejtësisë do t'i duhen plotë 132 vite, që nënkupton diçka objektivisht të paarrtshme. Për këtë arsye, rruga drejt zgjidhjes së lëndëve të cilat barten vit pas viti, duhet të ndryshojë rrënjësisht.

Në këtë drejtim, gjetjet tregojnë për nevojën e domosdoshme të angazhimit të KGJK-së në dy drejtime.

Fillimisht, gjyqtarët të cilët nuk e arrijnë normën vjetore, duhet që kjo të reflektohet në vlerësim të performancës dhe të merren masa sipas politikave të KGJK-së. Nëse secili prej 99 gjyqtarëve të divizioneve civile do ta arrinte normën vjetore të numrit të lëndëve të kryera, do të kishim gjithsej 32.571 lëndë të kryera, e jo 10.413 lëndë të kryera, siç ka qenë numri i lëndëve të kryera gjatë vitit 2018. Përballë numrit prej 10.247 lëndë të pranuar, numri i lëndëve të trashëguara vit pas viti do të binte edhe për 22.324 lëndë. Më 30 qershor 2019, numri i lëndëve të pazgjidhura në

fund të periudhës raportuese ka qenë 44.047, që nënkupton se sikur të zbatohet norma, lëndët e pazgjidhura të cilat barten vit pas viti do të përfundonin për pak më shumë se dy vite, dhe sistemi gjyqësor do të arrinte stabilitetin në kuptim të ngarkesës së gjyqësorit me lëndë civile.

Në anën tjetër, nuk mohohet fakti se norma e përcaktuar nga KGJK është një normë orientuese. Por, nuk nënkuptohet se e njëjta është e pavlerë. Në këtë drejtim, përderisa KGJK ka një rregullore e cila përcakton normat orientuese për gjyqtarë, të cilën normë gjyqtarët nuk e arrijnë, është e pakuptimt që sistemi gjyqësor të kërkojë rritjen e numrit të gjyqtarëve.

Për këtë arsye, KGJK duhet të rianalizojë në detaje dhe të jap përkushtim maksimal për ndryshimin e rregullores mbi normat orientuese, marrë për bazë faktin se numri i lëndëve civile të cilat barten vit pas viti, është problemi kryesor i sistemit gjyqësor, sa i përket drejtësisë civile. Pas këtij rianalizimi dhe mbajtjes përgjegjës të gjyqtarëve që kanë performancë të dobët sipas ligjit dhe politikave të KGJK-së, atëherë gjyqësori mund të angazhohet që të kërkojë rritjen e numrit të gjyqtarëve në divizionet civile.

Nëse e shikojmë gjendjen me numër të lëndëve civile sipas GjTh-ve, atëherë shohim se GjTh në Prishtinë është Gjykata më e ngarkuar me lëndë civile, me gjithsej 25.502 lëndë më punë gjatë vitit 2018 dhe 23.456 lëndë civile në punë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019.

Por, sa i përket përqindjes së numrit të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë, duhet të potencohet fakti se asnjë Gjykatë nuk e kalon 41 përqindëshin. Në këtë kuptim, gjatë vitit 2018 GjTh në Prishtinë ka përqindjen më të ulët të numrit të lëndëve të kryera në raport me numrin e lëndëve në punë (21 %) derisa GjTh në Ferizaj ka përqindjen më të lartë të numrit të lëndëve të zgjidhura përballë numrit të lëndëve të punë (41 %). Renditje e njëjtë vërehet edhe sa i përket gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, përkatësisht GjTh në Prishtinë me 14 % të lëndëve të zgjidhura dhe ajo në Ferizaj me 32% të lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuar.

	2018					2019				
	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura	Përqindja %	Në punë	Të zgjidhura	Përqindja %	Të pazgjidhura	Përqindja %
Prishtinë	25,502	5,304	21%	20,198	79%	23,456	3,380	14%	20,076	86%
Mitrovicë	7,008	2,052	29%	5,036	71%	6,301	1,202	19%	5,099	81%
Gjilan	5,810	1,606	28%	4,202	72%	5,217	1,013	19%	4,204	81%
Ferizaj	4,263	1,759	41%	2,509	59%	3,425	1,107	32%	2,318	68%
Pejë	7,815	2,492	32%	5,323	68%	6,820	1,465	21%	5,355	79%
Prizren	5,348	1,893	35%	3,455	65%	4,798	1,262	26%	3,536	74%
Gjakovë	5,155	1,667	32%	3,488	68%	4,442	984	22%	3,458	78%

Tabela 1 - Gjendja me lëndë civile e GjTh-ve gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të parë të vitit 2019.

4.1. Përformanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatat Themelore


Bazuar në raportet zyrtare të KGJK-së, GjTh të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018 kanë zgjidhur 16.768 lëndë civile, derisa kanë pranuar 19.609 lëndë. Në total, gjatë vitit 2018, divizionet civile të GjTh-ve kanë pasur në punë 60.981 lëndë.

Nga kjo statistikë vërehet se gjyqtarët gjatë vitit 2018 nuk kanë arritur që të kryejnë lëndë aq sa edhe kanë pranuar, dhe kjo ka rezultuar që numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 të rritet edhe për 2.841 lëndë.

Gjatë vitit 2018, në Divizionet Civile të GjTh-ve në total kanë qenë të angazhuar 92 gjyqtarë.

Nëse shikohet mesatarja, rezulton se gjatë vitit 2018 secili gjyqtar ka pranuar nga 213 lëndë të reja në punë, derisa kanë kryer nga 182 lëndë. Në total, i bie se secili gjyqtar në divizionet civile ka qenë i ngarkuar me nga afërsisht 663 lëndë.

Në raport me numrin e lëndëve me të cilat një gjyqtar ka qenë i ngarkuar brenda një viti, del se mesatarisht gjyqtarët kanë zgjidhur 27% të lëndëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar.



Grafika 2 - Numri i lëndëve civile të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2018 nga një gjykatës në Divizionin Civil.

Përpos kësaj, gjatë vitit 2018, divizionet civile kanë qenë të ngarkuara edhe me 8049 lëndë jo kontestimore dhe 1503 trashëgimore, ku kanë zgjedhur 3935 lëndë jo-kontestimore dhe 634 trashëgimore.

Në mesatare rezulton se përpos lëndëve civile, gjyqtarët kanë qenë të ngarkuar edhe me nga 87.4 lëndë jo kontestimore dhe 16.3 lëndë trashëgimore, ku mesatarisht kanë zgjidhur edhe nga afro 42.7 lëndë jo-kontestimore dhe nga 6.8 lëndë trashëgimore.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni civil është është 27 lëndë, ndërsa norma vjetore 329 lëndë.

Pra, në këtë mënyrë, sipas mesatares, Gjyqtarët e Dizioneve Civile nuk kanë arritur të përmbushin normën vjetore të lëndëve, pasi përballë obligimit të tyre që në vit t'i kryejnë nga 329 lëndë, të njëjtit kanë kryer nga 182 lëndë, përkatësisht nga 147 lëndë më pak.

Lidhur me performancën individuale të gjyqtarëve, KGJK ka bërë një hap pozitiv në kuptim të transparencës, pasi në fund të vitit 2018, KGJK ka publikuar raportin individual të punës së gjyqtarëve, në të cilin raport paraqitet numri i lëndëve që secili gjyqtar ka kryer.

Sipas këtij raporti, shihet se ka Gjyqtarë të cilët e kanë tejkaluar normën, derisa ka edhe gjyqtarë të tjerë që nuk e kanë arritur këtë normë. Në këtë mënyrë, IKD gjenë se ka një disbalanc të madh në mesin e gjyqtarëve sa i përket kryerjes së numrit të lëndëve.

Sipas këtij raporti, tre (3) gjyqtarët që kanë kryer numrin më të madh të lëndëve janë: Binak Duqi – GjTh Prishtinë – Dega Podujevë me 454 lëndë apo 125 lëndë më shumë se sa norma vjetore, i dyti renditet Bujar Muzaqi – GjTh Prishtinë-Dega Podujevë me 356 lëndë apo 27 lëndë më shumë se sa norma vjetore, ndërsa Shaban Zeqiraj – GjTh Prizren-Dega Suharekë gjatë vitit 2018 ka kryer 334 lëndë apo 5 lëndë më shumë se sa norma vjetore.

Në anën tjetër, sipas këtij raporti, tre (3) gjyqtarët që kanë kryer numrin më të vogël të lëndëve gjatë vitit 2018 janë: Milorad Mitković nga Gjykata Themelore në Gjilan me 82 lëndë të kryera, Millena Derziq nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Gracanicë me 113 lëndë të kryera dhe Negjat Musaj nga Gjykata Themelore në Pejë, dega në Decan me 118 lëndë të kryera.¹⁵

Bazuar në raportet zyrtare të KGJK-së, GjTh të Republikës së Kosovës gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019 kanë zgjidhur 10.413 lëndë civile, derisa kanë pranuar 10247 lëndë. Në total, ky departament ka qenë i ngarkuar me gjithsej 54.460 lëndë.


Nga kjo statistikë shihet se gjyqtarët e divizioneve civile në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 kanë arritur që të kryejnë pak lëndë më shumë se sa që kanë pranuar, përkatësisht kanë zgjidhur 166 lëndë më shumë se sa që kanë pranuar. Mesatarisht, secili gjykatës në divizionet civile ka qenë i ngarkuar me nga 561 lëndë.

Gjatë vitit 2019, numri i gjyqtarëve në divizionet civile është rritur edhe për shtatë (7) gjyqtarë, ku në total, gjatë këtij viti në këto divizione kanë qenë të angazhuar 99 gjyqtarë.

Nëse shikohet mesatarja, rezulton se gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019 secili gjyqtar ka pranuar mesatarisht nga 103.5 lëndë të reja lëndë të reja në punë, derisa kanë kryer nga 105 lëndë. Mesatarisht, secili gjykatës në divizionet civile ka qenë i ngarkuar me nga 550 lëndë.

Në raport me numrin e lëndëve me të cilat një gjyqtar ka qenë i ngarkuar brenda një viti, del se mesatarisht gjyqtarët kanë zgjidhur 19% të lëndëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar.

¹⁵ *Shënim:* IKD nuk ka informacione zyrtare për arsyet e mospërbushjes së normës nga ana e këtyre gjyqtarëve, nëse të njëjtit kanë pasur performancë të dobët, kanë punuar për një kohë të caktuar apo kanë arsye të qëndrueshme për një gjë të tillë.



Grafika 3 - Numri i lëndëve civile të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2018 nga një gjykatës në Divizionin Civil.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni civil është është 27 lëndë, ndërsa norma vjetore 329 lëndë.

Nëse kalkulohet norma mujore me 6 muaj, nënkupton se gjyqtarët është dashur t'i kryejnë nga 162 lëndë. Pra, në mesatare, Gjyqtarët e Divizioneve Civile nuk kanë përmbushur normën e përcaktuar nga KGJK. Kjo pasi gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, gjyqtarët mesatarisht kanë kryer nga 105 lëndë, përkatësisht nga 57 lëndë më pak se sa norma orientuese e përcaktuar nga KGJK.

Përpos kësaj, në Gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, divizionet civile kanë qenë të ngarkuara edhe me 6167 lëndë jo kontestimore dhe 1277 trashëgimore, ku kanë zgjedhur 2026 lëndë jo-kontestimore dhe 469 trashëgimore.

Në mesatare i bie që përpod lëndëve civile, gjyqtarët kanë qenë të ngarkuar edhe me nga 62.3 lëndë jo kontestimore dhe 12.8 lëndë trashëgimore, ku mesatarisht kanë zgjidhur edhe nga 20.4 lëndë jo-kontestimore dhe nga 4.7 lëndë trashëgimore.

Sa i përket gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, bazuar në raportin që IKD ka siguruar nga KGJK del se gjyqtari me numrin më të madh të lëndëve përsëri është Binad Duqi nga GjTh në Prishtinë – Dega në Podujevë me gjithsej 334 lëndë apo 172 lëndë më shumë se sa norma e përcaktuar, pasuar nga Nazim Neziri nga GjTh në Prishtinë – Dega në Podujevë me 233 lëndë të kryera apo 71 lëndë më shumë se sa norma e përcaktuar dhe Mirlinda Rexhepi nga Gjykata

Themelore në Ferizaj me 183 lëndë të zgjidhura apo 21 lëndë më shumë se sa norma e përcaktuar nga KGJK.

Në anën tjetër, ka edhe gjyqtarë të tjerë që gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019 kanë kryer lëndë nën normën e përcaktuar nga KGJK. Sipas raportit të KGJK-së të siguruar nga IKD përmes kërkesës për qasje në dokumente publike, gjyqtarët që më së paku kanë kryer lëndë janë: Afijete Sada nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec dhe Prenk Palushi nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë me nga gjithsej 26 lëndë apo 136 lëndë më pak se sa norma e përcaktuar dhe Jovica Mitrovic nga Gjykata Themelore në Prishtinë me gjithsej 29 lëndë të kryera apo 133 lëndë më pak se sa norma e përcaktuar nga KGJK¹⁶.

4.2. Ngarkesa me lëndë sipas llojit të kontesteve dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve civile

Gjatë vitit 2018, nga numri total i lëndëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës (41372 lëndë në punë), numri më i madh i kontesteve kanë qenë nga kategoria e kontesteve për kompensim të dëmit (18716 lëndë) dhe kontesteve nga e drejta reale (15473 lëndë).

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve, Gjykatat e Republikës së Kosovës kanë zgjidhur me aktgjykime gjyqësore gjithsej 7689 lëndë, me marrëveshje gjyqësore 1644 lëndë, në 558 raste është hudhur poshtë padia derisa në 4540 lëndë është tërhequr padia.

Në 1151 lëndë ka pasur ndërprerje të procedurës, derisa 1213 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

¹⁶ *Sqarim:* IKD në këtë rast ka marrë për bazë vetëm gjyqtarët që sipas raportit të KGJK-së kanë kryer lëndë çdo muaj.

Llojet e kontesteve	Numri i lëndëve në punë	Aktgjykim gjykues	Marrëveshje gjyqësore	Hudhje poshtë	Tërheqje	Ndërprerje të procedurës	Mënyrë tjetër
Kontestet marrëdhënjeve martesore dhe familjare	5377	2143	81	54	496	53	102
Kontestet trashëgimisë	109	3	1	2	3	1	1
Kontestet nga drejta reale	15473	1636	192	154	1054	498	257
Kontestet në bazë kontratës dhe veprimeve juridike	12391	791	326	119	732	190	178
Kontestet nga lëmija e ndërtimtarisë	62	2	5	0	1	0	0
Kontestet lidhur me komunalitet dhe shërbimet ngjashme	1662	22	4	4	58	19	13
Kontestet për kompensimin e dëmit	18716	1730	881	149	1802	268	374
Kontestet e punës	4440	972	68	40	174	73	196
Konteste tjera të cilat nuk janë sistemuar në kontestet e mësipërme	2751	390	86	36	220	49	92
Total	41372	7689	1644	558	4540	1151	1213

Tabela 3: Ngarkesa me lëndë dhe mënyra e kryerjes së lëndëve civile sipas llojit të kontestit për vitin 2018.

Sa i përket periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, nga numri total i lëndëve në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës (54460 lëndë në punë), numri më i madh i kontesteve kanë qenë nga kategoria e kontesteve për kompensim të dëmit (17131 lëndë) dhe kontesteve nga drejta reale (13458 lëndë).

Sa i përket mënyrës së zgjidhjes së lëndëve, Gjykatat e Republikës së Kosovës kanë zgjidhur me aktgjykime gjyqësore gjithsej 4791 lëndë, me marrëveshje gjyqësore 1198 lëndë, në 2642 raste është hudhur poshtë padia, derisa në 362 lëndë është tërhequr padia.

Në 637 lëndë ka pasur ndërprerje të procedurës, derisa 783 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

Llojet kontesteve	Numri i lëndëve në punë	Aktgjykim gjykues	Marrëveshje gjyqësore	Hudhje poshtë	Tërheqje	Ndërprerje të procedurës	Mënyrë tjetër
Kontestet marrëdhënjeve martesore dhe familjare	3952	1022	46	23	287	20	59
Kontestet trashëgimisë	108	2	1	0	1	0	1
Kontestet nga drejta reale	13458	810	76	65	481	231	130
Kontestet në bazë kontratës dhe veprimeve juridike	11566	597	286	42	435	101	115
Kontestet nga lëmija e ndërtimtarisë	59	0	2	0	3	0	0
Kontestet lidhur me komunalitetin dhe shërbimet e ngjashme	1546	14	3	0	21	3	4
Kontestet për kompensimin e dëmit	17131	1267	691	157	1057	219	329
Kontestet e punës	4173	846	38	50	194	26	69
Konteste tjera të cilat nuk janë sistemuar në kontestet e mësipërme	2467	233	55	25	163	37	76
Total	54460	4791	1198	362	2642	637	783

Tabela 4: Ngarkesa me lëndë dhe mënyra e kryerjes së lëndëve civile sipas llojit të kontestit për gjashtë mujorin e parë të vitin 2019.

5. Ngarkesa me lëndë civile e Gjykatës së Apelit


Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të Divizionit Civil të Gjykatës së Apelit, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që ky divizion ka pasur që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, Gjykata e Apelit në vitin 2016 kanë pasur në punë gjithsej 13416 lëndë civile, ku 8331 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 5085 lëndë i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit ka zgjidhur gjithsej 3554 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 9862 lëndë.

Sa i përket vitit 2017, Gjykata e Apelit ka pasur në punë gjithsej 15725 lëndë civile, ku 9862 prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 5863 lëndë i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2017, Gjykata e Apelit ka zgjidhur gjithsej 4400 lëndë civile, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 11325 lëndë.

Në vitin 2018, Gjykata e Apelit ka pasur në punë gjithsej 17012 lëndë civile, ku 11325 lëndë prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 5658 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Në vitin 2018, Gjykata e Apelit ka zgjidhur gjithsej 5461 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 11551 lëndë.

Gjashtë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, Gjykata e Apelit ka pasur në punë gjithsej 14795 lëndë civile, ku 11551 lëndë prej tyre i kanë trashëguar nga viti paraprak, ndërsa 3244 i kanë pranuar gjatë këtij viti. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykata e Apelit ka zgjidhur gjithsej 4199 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 10596 lëndë.



Grafika 4 - Përqindja e lëndëve të zgjidhura dhe të pazgjidhura në Divizionin Civil të GJA gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019.

Nëse shikojmë trendet e numrit të lëndëve në Gjykatën e Apelit që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019, atëherë shohim se numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese është rritur vit pas viti deri në vitin 2018, derisa ky numër ka rënë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019. Në vitin 2016, në Gjykatën e Apelit kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej 9.862 lëndë, derisa në vitin 2017 ky numër është rritur për 1.463 lëndë (11.325 lëndë të pazgjidhura) dhe për 226 lëndë të tjera (11.551 lëndë të pazgjidhura). Ky numër ka rënë për 955 lëndë (10.596 lëndë të pazgjidhura).

Por, në rastin e Gjykatës së Apelit, për dallim nga GjTh-të, nuk bëhet fjalë për ulje të numrit të lëndëve të zgjidhura si faktor për rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura në fund të periudhës raportuese. Në rastin e Gjykatës së Apelit më së shumti ka ndikuar rritja e numrit të lëndëve të pranuar, pasi numri i lëndëve të zgjidhura është rritur vit pas viti. Në vitin 2016, Gjykata e Apelit ka pranuar 5,085 lëndë, derisa në vitin 2017 ky numër është rritur për gjithsej 778 lëndë (5863 lëndë të pranuar në vitin 2017). Në vitin 2018, Gjykata e Apelit ka pranuar 5.658 lëndë të reja, që i bie 205 lëndë më pak se sa në vitin 2017, por 573 lëndë më shumë se sa në vitin 2016. Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, Gjykata e Apelit ka pranuar gjithsej 3.244 lëndë në punë, që nëse vazhdon me këtë trend, numri i lëndëve të pranuar në vitin 2019, do ta tejkalojë numrin e lëndëve të pranuar në vitin 2018.

Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura, në vitin 2016, Gjyqtarët e Divizionit Civil në GJA kanë kryer gjithsej 3.554 lëndë, derisa në vitin 2017 ky numër është rritur gjithsej 846 lëndë (4.400 lëndë të kryera) dhe për 1.061 lëndë të zgjidhura në vitin 2018 (gjithsej 5.461 lëndë të zgjidhura).

Numri i gjyqtarëve në divizionin civil të Gjykatës së Apelit, me disa lëvizje brenda viteve, është rritur nga viti 2016 deri në vitin 2018, përderisa rritjen më të madhe ky divizion i kësaj gjykate e ka pasur në vitin 2019.

Në fillim të vitin 2016 divizioni civil i GjA kishte 14 gjyqtarë, derisa në fund të këtij viti kishte 12 gjyqtar. Deri në gusht të vitit 2017, Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit ka pasur 13 gjyqtarë, derisa në fund të këtij viti ka pasur 16 gjyqtarë. Gjatë vitit 2017, në këtë divizion kanë qenë të angazhuar 17 gjyqtarë.

Pra, nëse këto të dhëna i ndërlidhim me numrin e lëndëve të zgjidhura, atëherë shohim se ngritja e numrit të gjyqtarëve në Divizionin Civil të GjA ka ndikuar edhe në ngritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura.

Në fillim të vitit 2019, në GjA ishin avansuar edhe 10 gjyqtarë të rinjë, 9 prej të cilëve ishin angazhuar në Divizionin Civil të kësaj Gjykate. Rritja e këtij numri ka ndikuar edhe në rritjen e performancës së kësaj gjykate në kuptim të numrit të lëndëve të pazgjidhura, pasi gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, Gjyqtarët e Divizionit Civil të GjA kanë zgjidhur gjithsej 4199 lëndë. Nëse vazhdohet me këtë trend, në fund të vitit 2019 GjA do t'i ketë të zgjidhura rreth 8.400 lëndë. Nëse e krahasojmë këtë numër me trendin e lëndëve të pranuar deri në fund të vitit 2019, atëherë i bie se GjA do të kryejë rreth 2.000 lëndë civile më shumë se sa numri i lëndëve të pranuar në punë.

Nëse shkon me këtë ritëm, i cili jo domosdoshmërisht është vlerësim preciz, Gjykatës së Apelit do t'i duhen mbi 5 vite për të zgjidhur numrin e lëndëve të trashëguara të cilat barten vit pas viti, që nënkupton se kjo gjykatë do të arrij stabilitet në kuptim të numrit të lëndëve civile në vitin 2025.

Në këtë mënyrë, këto të dhëna tregojnë se Gjykata e Apelit aktualisht nuk gëzon një stabilitet me lëndë civile, por që nëse veprohet në këtë mënyrë, ky stabilitet mund të arrihet nëse gjyqtarët vazhdojnë me këtë efikasitet. Nëse Divizionit civil të Gjykatës së Apelit i shtohen edhe 2 apo 3 gjyqtarë, dhe kjo pasohet me një strategji për uljen e numrit të lëndëve në këtë gjykatë, e cila strategji do të përcaktonte procedura standarde të veprimit në disa lëndë, stabiliteti i kërkuar do të mund të arrihej shumë më shpejtë.


5.1. Performanca e zgjidhjes së rasteve civile në Gjykatën e Apelit

Bazuar në raportet zyrtare të KGJK-së, GjA gjatë vitit 2018 ka zgjidhur 5461, ndërsa ka pranuar 5.687, ku në total gjatë vitit 2018, divizionet civile të GjA ka pasur në punë gjithsej 17.012 lëndë.

Nga kjo statistikë shihet se Gjyqtarët e Apelit gjatë vitit 2018, nuk kanë arritur që të kryejnë lëndë aq sa kanë pranuar, dhe kjo ka rezultuar që numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 të rritet edhe për 226 lëndë të reja.

Në GjA gjatë vitit 2018 kanë qenë të angazhuar 17 gjyqtarë. Mesatarisht, gjatë vitit 2018 secili gjyqtar në divizionin civil të GjA ka pranuar nga 334.5 lëndë të reja, ndërsa ka kryer nga 321.2 lëndë, derisa secili gjyqtar në divizionin civil të GjA ka qenë i ngarkuar me nga mbi 1.000 lëndë.

Nëse llogaritet numri i lëndëve me të cilat një gjyqtar ka qenë i ngarkuar brenda një viti, del se mesatarisht gjyqtarët e Apelit, kanë zgjidhur 32% të lëndëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar.



Grafika 5 - Numri i lëndëve civile të zgjidhura dhe të pazgjidhura gjatë vitit 2018.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në GjA - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni civil është është 18, ndërsa norma vjetore 219.

Pra, Gjyqtarët në divizionin civil të GjA gjatë vitit 2018 kanë tejkaluar normën orientuese, në atë mënyrë që mesatarisht, secili gjyqtar i Divizionit Civil në GjA ka kryer mesatarisht 102 lëndë më shumë se sa norma vjetore.

Lidhur me performancës individuale të Gjyqtarëve, KGJK ka bërë një hap pozitiv në kuptim të transparencës, pasi në fund të vitit 2018, KGJK ka publikuar raportin individual të punës së gjyqtarëve, në të cilin raport paraqitet numri i lëndëve që secili gjyqtar ka kryer.

Sipas këtij raporti, për dallim nga Gjykatat Themelore, nuk ka një disbalanc të madh në mesin gjyqtarëve sa i përket numrit të lëndëve të kryera gjatë një viti. Në fakt, ky disbalanc shfaqet vetëm sa i përket Kryetarit të GjA, Hasan Shala, i cili sipas këtij raporti, rezulton se gjatë vitit 2018 ka kryer gjithsej 874 lëndë, numër ky që përbën pothuajse katër fishin e normës vjetore për gjyqtarë.


Për nga numri i lëndëve të kryera, Shala pasohet nga Rafet Haxhaj me 337 lëndë të kryera dhe Gani Avdiu me 334 lëndë të kryera.

Por, këto konstatime vlejné vetëm për Divizionin Civil të GjA me seli në Prishtinë, dhe jo edhe për Gjyqtarët e Divizionit të GjA në Mitrovicë. Sipas këtij raporti, numri i lëndëve të zgjidhura nga këta gjyqtarë është jashtëzakonisht i vogël, përkatësisht Blagoje Miletiq me 16 lëndë të kryera gjatë vitit 2018, Mirko Rakiq me 12 lëndë të kryera dhe Miroslav Ivanoviq me 10 lëndë të kryera.

Në anën tjetër, gjatë periudhës kohore 1 janar – 30 qershor 2019, Divizioni Civil i Gjykatës së Apelit ka zgjidhur gjithsej 4199 lëndë, derisa ka pranuar 3244 lëndë të reja. Në total, ky divizion në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka qenë i ngarkuar me 14795 lëndë në punë.

Nëse e shikohet mesatarja, rezulton se në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 secili gjyqtar ka zgjidhur nga 149 lëndë, ka pranuar 115.8 lëndë të reja, derisa në total, mesatarisht, secili gjyqtar ka qenë i ngarkuar me nga 528.3 lëndë.

Në raport me numrin e lëndëve me të cilat një gjyqtar ka qenë i ngarkuar brenda një viti, del se mesatarisht gjyqtarët kanë zgjidhur 28.3% të lëndëve me të cilat kanë qenë të ngarkuar.



Grafika 6- Numri i lëndëve civile të zgjidhura dhe të pazgjidhura në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019.

Sipas rregullores për caktimin e normave të punës së gjyqtarëve, të miratuar nga KGJK më 14 shtator 2011, norma mujore e një gjyqtari në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni civil është është 18, që nëse shumëzohet me gjashtë muaj, nënkupton se është 108 lëndë.

Pra, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, mesatarisht, gjyqtarët kanë tejkaluar normën orientuese, në atë mënyrë që kanë kryer nga 41 lëndë mbi normën orientuese.

Sa i përket raportit individual të punës së gjyqtarëve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, edhe gjatë kësaj periudhe kohore për nga numri i lëndëve të kryera prinë Kryetari i GjA, Hasan Shala, me gjithsej 415 lëndë të kryera, pasuar nga Rafet Haxhaj me 202 lëndë të kryera dhe Gani Avdiu me 172 lëndë të kryera.

Sikurse në vitin 2018, edhe në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, gjyqtarët e Divizionit të GjA në Mitrovicë nuk kanë treguar performancë të mjaftueshme në kuptim të numrit të lëndëve të zgjidhura, ndonëse për dallim nga viti i kaluar ka një ngritje të këtij numri. Sipas raportit individual të punës së gjyqtarëve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjyqtari Blagoje Miletiq gjatë kësaj periudhe kohore ka zgjidhur 43 lëndë, Gjyqtari Miroslav Ivanoviq 25 lëndë, ndërsa Gjyqtari Mirko Rakiq ka kryer vetëm 12 lëndë, i cili edhe është pensionuar gjatë kësaj periudhe kohore.

6. Trajtimi i rasteve civile në Gjykatën Supreme

Sa i përket ngarkesës me lëndë, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës tanimë ka arritur një stabilitet me lëndët civile. Në fund të vitit 2018, numri i lëndëve të bartura në vitin 2019 ishte vetëm 100 lëndë. Rrjedhimisht, tani kjo gjykatë mund të garantoj mjetin efikas juridik, në atë mënyrë që rastet të përfundohen brenda një afati të arsyeshëm.

Sa i përket vitit 2018, Gjykata Supreme ka pasur në punë 466 lëndë civile (me revizion dhe me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë), ku 32 prej tyre i kishte trashëguar nga viti 2017, derisa 434 lëndë të reja i kishte pranuar në punë gjatë vitit 2018. Gjatë kësaj periudhe kohore, kjo Gjykatë kishte zgjidhur 404 lëndë civile, derisa të pazgjidhura kishin mbetur gjithsej 62 lëndë.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, Gjykata Supreme ka pasur në punë gjithsej 280 lëndë në punë (me revizion dhe me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë), 62 prej të cilave i kishte trashëguar nga viti 2018, ndërsa në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 kishte pranuar edhe 218 lëndë të reja. Gjatë kësaj periudhe kohore, Gjykata Supreme ka zgjidhur gjithsej 199 lëndë, derisa kanë mbetur të pazgjidhura edhe 81 lëndë.

7. Gjetjet e monitorimit të IKD-së në trajtimin e rasteve civile

IKD përpos monitorimit sistematik në trajtimin e rasteve të korrupsionit, krimeve të rënda, departamenteve të përgjithshme dhe rasteve administrative, ka monitoruar edhe rastet civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe degët e tyre.

Gjatë periudhës kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019, IKD ka monitoruar gjithsej 1884 seanca të natyrës civile në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës.

Prej këtyre 1844 seancave të monitoruara, 1404 janë mbajtur, ndërsa 440 janë shtyrë. Arsytet e shtyrjes së seancave janë kryesisht mungesat e palëve të përfshira në këto raste civile. Prej 440 seancave të shtyra, 117 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së gjykatësit, 169 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së paditësit, 138 seanca janë shtyrë për shkak të mungesës së palës së paditur dhe 16 seanca janë shtyrë për arsye tjera.

Si rezultat i monitorimit sistematik, IKD në këtë pjesë të raportit ka paraqitur edhe gjetjet në këto raste si dhe ka trajtuar raste të përzgjedhura karakteristike.

Sa i përket trajtimit të rasteve civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës, IKD gjenë se ky sistem ka dështuar në ofrimin e një mjeti efikas juridik për këto raste.

Por, sa i përket mjetit efikas juridik, kjo nuk ndodh kështu me të gjitha rastet civile, pasi që kemi një qasje selektive nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim, përderisa kemi raste të cilat as pas dy dekadave nuk kanë marrë një përgjigje përfundimtare nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ka raste të tjera të cilat përfundojnë brenda 35 ditëve.

Po ashtu, në rastet civile dukuria e kthimit të lëndëve në rigjykim nga GjA është duke u rritur vit pas viti, çfarë po ndikon në krijimin e “ping-pongut” me lëndë në mes instancave të ndryshme brenda sistemit gjyqësor. Në këtë mënyrë, kjo qasje e GjA përpos që zvarritë qytetarët në realizimin e të drejtave të tyre përmes rrugëve gjyqësore, edhe ngarkon sistemin gjyqësor me numër të lëndëve.

7.1. Dështimi i sistemit gjyqësor në sigurimin e mjetit efikas juridik në rastet civile

Ndonëse me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, aktet ndërkombëtare të zbatuara drejt për së drejti në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe vetë kornizën ligjore garantohet e drejta për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, sistemi gjyqësor në rastet civile në shumicën dërrmuese të rasteve nuk garanton një proces gjyqësor brenda një afati të tillë.

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) periodha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente.¹⁷

Sipas statistikave të KGJK-së, në rastet civile, mesatarja e kohëzgjatjes së procedurës vetëm në shkallë në shkallë të parë gjatë vitit 2018 ka qenë gjithsej 962 ditë. Ndërsa, sipas këtyre statistikave të KGJK-së, në Gjykatë të Apelit, mesatarja e kohëzgjatjes së një procedurave civile gjatë vitit 2018 ka qenë 772 ditë.

Pra në total, sipas statistikave të KGJK-së, kohëzgjatja e një rasti civil nga data e paraqitjes së padisë e deri sa i njëjti të marrë formë të prerë pas aktgjykimit nga Gjykata e Apelit është gjithsej 1734 ditë.

Por, KGJK nuk i nxjerrë këto statistika duke kalkuluar kohëzgjatjen e secilit rast veç e veç, e që pastaj të nxjerrët mesatarja. Kjo bëhet duke u bazuar në një formulë matematikore, të cilët e aplikon KGJK në këto raste.

Në këtë drejtim, ndonëse mesatarja e kohëzgjatjes prej 1734 ditë për një lëndë civile në start paraqet dështim të sistemit gjyqësor në sigurimin e një mjeti efektiv juridik, nga monitorimi sistematik, IKD ka gjetur se në rastet e monitoruara, sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës i duhet mesatarisht 2 vite e 11 muaj që pas paraqitjes së padisë, vetëm të caktojë seancën përgatitore. Sa i përket seancës përgatitore, Ligji për Procedurën Kontestimore përcakton:

Seanca përgatitore mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit.¹⁸

Përkritazi me zbatimin e këtij obligimi ligjor nga sistemi gjyqësor, IKD ka analizuar gjithsej 116 raste civile, ku për secilin prej tyre ka llogaritur kohën e kaluar nga data e paraqitjes së padisë deri në datën e caktimit të seancës përgatitore:

¹⁷Raporti Vjetor 2016. Nr.16. Institucioni i Avokatit të Popullit. 2017. Prishtinë. F.23. (Shih linkun https://oik-rks.org/ep-content/uploads/2017/12/Raporti_vjetor_SHQIP_nr16_me_kopertine_per_ëeb_204801.pdf). (Qasur për herë të fundit më 26 shtator 2019).

¹⁸Ligji 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. Neni 400.4

Gjykata Themelore Prishtinë		Gjykata Themelore Mitrovicë		Gjykata Themelore Prizren		Gjykata Themelore Gjakovë		Gjykata Themelore Pejë		Gjykata Themelore Ferizaj		Gjykata Themelore Gjilan	
<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>	<i>Data e paraqitjes së padisë</i>	<i>Caktimi i seancës përgatitore</i>
13.07.2015	31.07.2017	30.10.2009	05.06.2018	13.02.2015	16.07.2018	07.11.2016	16.01.2018	21.11.2016	25.10.2018	28.12.2016	21.11.2018	21.02.2017	26.07.2018
28.07.2017	16.01.2018	08.11.2011	21.06.2018	21.08.2013	16.01.2018	01.04.2015	05.10.2018	16.03.2017	12.12.2018	28.05.2014	03.12.2018	18.04.2017	05.07.2018
05.01.2016	11.09.2017	23.12.2015	23.03.2018	20.10.2016	16.02.2017	20.04.2016	25.01.2018	16.12.2016	12.06.2018	25.07.2016	05.12.2018	09.06.2017	12.11.2018
07.05.2007	09.08.2017	24.05.2016	10.09.2018	19.12.2016	09.02.2018	24.06.2016	25.01.2018	09.03.2016	14.11.2018	12.12.2016	08.11.2018	30.01.2018	19.12.2018
22.06.2010	29.10.2017	10.02.2016	15.02.2018	26.03.2015	25.02.2016	05.12.2017	11.09.2018	14.06.2017	12.11.2018	11.11.2016	07.06.2018	08.08.2017	12.09.2018
04.08.2014	14.12.2017	04.11.2016	02.05.2018	23.12.2015	28.13.2018	04.01.2012	07.09.2018	20.01.2017	18.01.2018	01.04.2016	09.03.2018	09.06.2017	04.07.2018
04.12.2009	07.12.2017	13.01.2014	10.05.2018	17.12.2014	22.05.2017	10.11.2015	31.08.2018	24.01.2017	02.11.2018	25.04.2014	16.03.2017	27.03.2017	08.08.2018
04.07.2013	06.11.2017	23.12.2015	23.03.2018	01.11.2017	16.03.2018	31.07.2017	22.02.2018	27.07.2018	29.10.2018	14.12.2015	06.11.2017	29.05.2017	12.09.2018
27.12.2011	08.11.2017	29.05.2015	16.01.2018	30.01.2007	05.12.2016	19.02.2016	15.01.2018	28.09.2016	26.10.2018	04.08.2016	12.12.2017	13.09.2017	17.09.2018
17.03.2006	12.04.2017	05.02.2009	22.02.2018	26.07.2016	23.02.2018	04.01.2017	15.01.2018	21.11.2016	25.10.2018	18.11.2015	19.01.2018	15.03.2017	03.07.2018
08.02.2011	04.09.2018	31.01.2007	22.11.2018	21.05.2014	22.02.2018	04.08.2017	22.02.2018	03.01.2013	16.10.2018	13.10.2014	17.10.2017	17.09.2018	04.12.2018
29.07.2013	23.05.2018	05.12.2015	22.11.2018	14.11.2016	21.06.2017	17.12.2010	23.05.2018	26.06.2016	05.06.2018	28.07.2009	19.09.2017	17.03.2018	21.12.2018
02.10.2013	22.06.2018	09.10.2013	17.04.2018	07.08.2012	12.12.2017	03.03.2017	15.02.2018	19.01.2015	12.12.2017	11.11.2016	07.06.2018	14.11.2017	04.10.2018
26.05.2011	18.09.2017	07.08.2015	22.02.2018	14.11.2017	20.03.2018	24.04.2017	25.07.2018	02.04.2016	30.01.2018	25.07.2016	05.12.2018	20.01.2018	01.11.2018
07.04.2015	18.06.2018	05.02.2009	22.02.2018	27.12.2016	14.08.2018	18.04.2017	04.10.2018	11.11.2011	09.01.2018	20.12.2016	21.11.2018	17.07.2014	11.06/2018
08.09.2016	16.10.2018	22.09.2016	12.11.21018	29.11.2016	16.01.2018	14.03.2018	28.09.2018	03.11.2015	05.06.2018	30.08.2017	13.12.2018	02.05.2018	07.11.2018

Tabela 5: Data e paraqitjes së padisë dhe data e caktimit të seancës përgatitore në 112 raste civile.

Në total të këtyre rasteve, mesatarja e kohës së kaluar nga data e paraqitjes së padisë dhe deri në datën e caktimit të seancës përgatitore është 2 vite e 11 muaj, apo mbi 1000 ditë.

Por, në mesin e këtyre 116 rasteve të analizuara, vërehet qasja selektive që sistemi gjyqësor bënë në rastet civile. Nga këto raste, IKD ka gjetur një rast i cili në gjykatë është paraqitur në vitin 2007, ndërsa seanca përgatitore është mbajtur në vitin 2017.

Në anën tjetër, në mesin e këtyre rasteve, IKD ka gjetur se në një rast, Gjykata Themelore në Gjakovë e kishte caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor brenda dy muajve, derisa po e njëjta Gjykatë në një rast tjetër, seancën përgatitore e kishte caktuar pas tetë viteve.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve, IKD vlerëson se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës nuk garanton një mjet efikas juridik. Realisht, ky sistem nuk garanton mbrojtje juridike të palëve në rastet civile.

Rrjedhimisht, vonesat e tilla ndikojnë në dy drejtime negative. Fillimisht, vonesat e tilla bëjnë që sistemi gjyqësor mos të jetë krah qytetarit në rastet kur të njëjtit i shkaktohet dëm nga kontestet juridiko civile. Tezgjatja e këtyre procedurave automatikisht nënkupton humbje të besimit të

qytetarëve në sistemin e drejtësisë. Në anën tjetër, kjo tejzgjatje zbehë vullnetin e qytetarëve që çështjet e tyre juridiko-civile t’i zgjidhin përmes rrugëve gjyqësore. Kjo zbehje në rastin konkret paraqitet si faktorë kriminogjen, ku qytetarët nxiten që ta marrin drejtësinë në duar dhe si rrjedhojë kryhen vepra të ndryshme penale, siç ka pasur edhe raste konkrete në të kaluarën.

Andaj, sistemi gjyqësor duhet ta kuptojë këtë situatë dhe pasojat e saj, dhe duhet që të investoj seriozisht që të respektohen afatet ligjore, në mënyrë që qytetarët mos të shpenzojnë dekada pritje për një padi të ushtruar në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

7.2. “Ping-Pongu” i GjTh-ve dhe GjA me rastet civile


Rritja e numrit të lëndëve civile në Gjykatat e shkallës së parë nuk vie çdoherë si pasojë e rritjes së numrit të padive të parashtruara nga personat fizik dhe juridik. Rritja e këtij numri vie edhe për shkak të kthimit të lëndëve në rivendosje nga GjA.

Dukuria e kthimit të shpeshtë të lëndëve në rigjykim nga GjA në GjTh krijon procedurën e “ping-pongut”, ku rasti i një pale nuk merr epilog për një kohë të gjatë, për faktin se rasti i tij kthehet vazhdimisht në rigjykim.

Në rastin konkret, kjo e dëmton si qytetarit ashtu edhe gjyqësorin. Kjo për arsye se qytetari duhet të fillojë procedurën përsëri nga pika zero, derisa gjyqësori mbetet ende me një lëndë aktive.

Sa i përket kthimit të lëndëve në rivendosje, IKD ka analizuar numrit e rasteve që janë kthyer në rivendosje nga GjA gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018, ku gjenë se kjo dukuri është duke u rritur vit pas viti.

Përderisa në vitin 2016 GjA kishte kthyer 1042 lëndë civile në rivendosje, ky numër ishte rritur për 192 lëndë në vitin 2017 (1234 lëndë civile të kthyera në rivendosje nga GjA) dhe për 217 lëndë të tjera në vitin 2018 (1451 lëndë civile të kthyera në rivendosje nga GjA).



Grafika 7 - Numri i lëndëve të kthyera në rigjykim nga GjA gjatë vitit 2016, 2017 dhe 2018.

Mbi këtë praktikë të ndërtuar nga GjA, IKD vlerëson se për t'i evituar vonesat e panevojshme dhe ngarkimin e GjTh-ve me lëndë që shkaktohen si pasojë e “ping pongut” të çështjeve civile prej një gjykatë në gjykatën tjetër, GjA gjatë shqyrtimit të vendimeve të atakuara të marrë përsipër zgjidhjen përfundimtare të rastit vetëm në ato raste kur vlerëson se mund të nxjerrë një vendim meritator lidhur me rastin përkthazi me vërtetimin e gjendjes faktike.

Sipas vlerësimit të IKD-së edhe GjA sikurse Gjykata e shkallës së parë është gjykatë e rregullt dhe e njëjta sipas ligjit ka autoritet që të vendosë në mënyrë të pavarur nga Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit direkt të çështjes, në bazë të provave të reja apo në bazë të marrjes rishtas të provave e konstaton drejtë gjendjen faktike dhe në bazë të kësaj ka të drejtë të vendos edhe pa e kthyer rastin në rivendosje. Për këtë arsye, GjA duhet të ndalojë praktikën e kthimit të lëndëve në rivendosje, përveç rasteve kur ky veprim është i domosdoshëm.

8. Annex 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike civile

1. Rasti civil me mbi dy dekada pa epilog

Gjykata Themelore në Pejë

Nr. i lëndës: C.nr.257/11

Paditës: Valdet Nikçi

E paditur: Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP)

Kontesti: Kompensim dëmi

Data e paraqitjes së padisë: 27 maj 1997

Valdeti Nikçi, ish-punëtor në ndërmarrjen shoqërore “Fabrika e Konstruktsioneve Metalike” në Pejë, e cila fabrikë tani është nën menaxhimin e AKP-së, më 27 maj 1997, kishte ngritur padi ndaj kësaj ndërmarrje për kompensimin e tri pagave personale nga marrëdhënia e punës.

Padia në fjalë ishte ngritur në ish-Gjykatën Komunale në Pejë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 27 tetor 2004, ish-Gjykata Komunale në Pejë, kishte aprovuar si të bazuar kërkesën për kompensim e pagave dhe kishte detyruar AKP-në që paditësit t’ia paguajë pagat mujore të papaguara, prej 1 qershorit 1995 deri më 31 mars 1999.

Vendimi i Gjykatës Komunale ishte bërë i formës së prerë. Por, më 30 prill 2010, AKP -ja parashtrroi kërkesë për përsëritje të procedurës. Më 20 prill 2011, shkalla e parë e Gjykatës së Qarkut, anuloi Aktgjykimin të ish-Gjykatës Komunale në Pejë dhe lejoi përsëritjen e procedurës.

Me reformimin e sistemit gjyqësor më 1 janar 2013, ky rast ka kaluar në Gjykatën Themelore të Pejës. Kjo Gjykatë filloi të shqyrtojë rastin, dhe e njëjta më 8 shkurt 2016, e kishte pezulluar shqyrtimin e procedurës kontestimore deri në përfundimin e procedurës së likuidimit.

Si pasojë e pezullimit të procedurës për shqyrtimin e padisë së paditësit për kompensimin e pagave, paditësi i ishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me pretendimin se të njëjtit i’u ishin shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Gjykata Kushtetuese kishte vendosur se pezullimi i pacaktuar i procedurës e privon parashtruesin e kërkesës nga një vendim përfundimtar lidhur me kërkesën e tij për pagimin e pagave të papaguara dhe si rrjedhojë me pezullimin e procedurës civile është shkelur nenit 31 (2) i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

Pretendimet e paditësi Valdet Nikçi për kompensimin e pagave prej 1997, edhe më tutje janë duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Pejë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Sa i përket trajtimit të këtij rasti nga sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, ky rast paraqet në mënyrë të hapur pazotësinë e sistemit gjyqësor për ti dhënë epilog rastit në fjalë.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së periudha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente¹⁹.

Që nga parashtrimi i padisë e deri më 30 qershor 2019 kanë kaluar hiq më pak se 8,069 ditë, apo mbi 22 vite. Gjatë tërë kësaj periudhe, paditësi nuk ka mundur që të marrë një përgjigje definitive nga sistemi gjyqësor. Për më tepër, sistemi gjyqësor këtij rasti nuk i kishte dhënë një epilog as pasi Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës pezullimin në kohë të pacaktuar e kishte konsideruar si kundër kushtetues.

IKD rikujton të gjithë akterët institucional të përfshirë në këtë rast, por edhe në raste të tjera të ngjashme, se Gjykimi në kohë të arsyeshme është një nga 3 elementet që sipas KEDNJ-së përbën të drejtën për një proces të rregullt. Në shumicën dërrmuese të rasteve, në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës nuk ka pasur mundësi që të zbatohet kjo e drejtë e qytetarëve, derisa arsyet kanë qenë të natyrave objektive dhe subjektive. Por, rasti në fjalë në të cilin padia është ende pa një epilog që nga viti 1997 nuk mund të arsyetohet me asnje faktorë, por mund të cilësohet si dështim i pastër i sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Andaj, IKD rekomandon që këtij rasti dhe rasteve të tjera me natyrë të ngjashme ti një trajtim meritator dhe profesional, derisa KGJK të mbajë përgjegjës për shkelje potenciale disiplinore akterët që kan ndikuar që ky rast ende të jetë pa përgjigje.

¹⁹ Raporti vjetor 2016. Nr.16. Institucioni i Avokatit të Popullit. 2007. f. 22-23. (https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2017/12/Raporti_vjetor_SHQIP_nr16_me_kopertine_per_web_204801.pdf). (Qasur për here të fundit më 28 tetor 2019).

2. Trajtimi i rastit civil për 35 ditë

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.321/18

Paditës: Adrianit Ibrahim, Leotrim Bytyqi, Hazer Mallaku, Lenart Berisha, Dukagjin Halitaj, Ragip Rexhepi, Visar Shehu, Taulant Nika dhe Avdi Prokshi

E paditur: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Data e paraqitjes së padisë: 2 shkurt 2018

Data e aktgjyimit të shkallës së parë: 9 mars 2018

Data e aktgjyimit të shkallës së dytë:

Më 2 shkurt të vitit 2018, paditësit Adrianit Ibrahim, Leotrim Bytyqi, Hazer Mallaku, Lenart Berisha, Dukagjin Halitaj, Ragip Rexhepi, Visar Shehu, Taulant Nika dhe Avdi Prokshi, kanë paditur MPB-në, konkretisht Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), i cili ka anuluar konkursin për pozitën inspektor/hetues të IPK-së, në të cilën pozitë, paditësit ishin përzgjedhur si kandidatë të suksesshëm.²⁰

Më 9 mars 2018 Gjykata Themelore në Prishtinë përkitazi me këtë rast, ka nxjerrë aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësve, duke marrë aktgjykim me të cilin ka anuluar vendimin e kryeshefit ekzekutiv të IPK-së, Hilmi Mehmeti, i cili kishte anuluar konkursin për pozitën inspektor/hetues të IPK-së.

Gjykata gjithashtu e ka obliguar këtë institucion që të vazhdojë procedurën e rekrutimit për pozitën inspektor/hetues të IPK-së, në të cilën pozitë, paditësit ishin përzgjedhur si kandidatë të suksesshëm.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ky rast është i kundërt me rastin paraprak. Kjo për arsye se përderisa ish-punëtori i Ndërmarrjes Shoqërore, Valdet Nikçi edhe pas 20 viteve nuk ka arritur të realizoj të drejtën e tij për kompensimin e pagave të papaguara dhe ende është duke pritur një përgjigje nga sistemi i drejtësisë, në anën tjetër, hasim një rast të natyrës së njëjtë të kontestit nga marrëdhënia e punës, e cila është përfunduar nga afat rekord nga Gjykata Themelore në Prishtinë. i

Në rastin konkret, prej momentit të paraqitjes së padisë deri në caktimin e seancës përgaditore kanë kaluar 26 ditë, praktikë kjo e rrallë në rastet civile në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës. Mosveprimin në këtë formë edhe në raste të tjera të ngjashme, sistemi gjyqësor i

²⁰"Gjykata rrezon vendimin e kryeshefit të IPK-së që anuloi konkursin për hetues, obligohet vazhdimi i procedurës së rekrutimit". Betimi për Drejtësi. 14 mars 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-rrezon-vendimin-e-kryeshefit-te-ipk-se-qe-anuloi-konkursin-per-hetues-obligohet-vazhdimi-i-procedures-se-rekrutimit/>). (Qasur për herë të fundit më 26 shtator 2019).

Republikës së Kosovës e arsyeton kryesisht me numrin e madh të lëndëve dhe numrin e vogël të gjyqtarëve.

Ndërsa, që nga paraqitja e padisë e deri në aktgjykimin e shkallës së parë, ky rast ka përfunduar për vetëm 35 ditë, derisa deri në aktgjykimin e formës kanë kaluar ?? ditë.

Arsyet se pse në këtë rast është vepruar në këtë mënyrë të veçantë për dallim prej shumicës dërrmuese të rasteve të tjera, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk i ka bërë të qarta. Ndaj këtij vendimi ishte parashtruar ankesë në Gjykatës e Apelit. Kjo e fundit më 22 gusht 2018 kishte refuzuar ankesat, duke lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë.

Duke pasur parasysh këtë rast dhe rastet e tjera të cilat presin mbi 22 vite për të marrë një epilog, IKD vlerëson se është pikërisht kjo qasje selektive e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës e cila ulë besimin e publikut në institucionet e drejtësisë, besim ky i cili funksionon në margjina minimale. Në këtë drejtim, IKD e ka parasysh se është e pamundur që kohëzgjatja e trajtimit të një rasti në secilin rast të jetë e njëjtë. Por, ballime të tilla si në këtë rast, janë plotësisht të paarsyeshme dhe të papranueshme.

3. Pezullimi i kundërligjshëmi procedurës civile nga Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr. i lëndës: C.nr.137/18

Paditës: Nushe Loxhaj - Bicaj

E paditur: Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re”.

Data e paraqitjes së padisë: 28/02/2018

Kontesti: Kompensim dëmi

Data e aktgjykimit të shkallës së parë: 14/10/2019

Për aksidentin e ndodhur më 27 janar të vitit 2016 dhe për lëndimet e pësuar nga ky aksident, Nushe Loxhaj -Bicaj dhe familjarët e saj, në korrik të vitit 2016, kishin ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, dega në Istog, duke kërkuar kompensim dëmi në shumë prej rreth një milion euro.

Padia ishte ushtruar ndaj kompanisë së sigurimeve “Kosova e Re”, pasi që vetura me të cilën ishte shkaktuar aksidenti, ishte e siguruar në këtë kompani, ndërsa lënda i ishte ndarë për ta gjykuar gjykatësit Daut Demiraj.

Ky proces gjyqësor kishte nisur më 13 janar të vitit 2017, në të cilën seancë, pala e paditur, kompania e sigurimeve “Kosova e Re”, kishte kërkuar që Dega e Istogut të shpallet jo-kompetente për të gjykuar këtë rast, me arsyetimin se paditësja nuk është me vendbanim në Istog, por në Prishtinë, kërkesë e cila ishte refuzuar nga gjykatësi Daut Demiraj.

Më pas, në seancën e 3 shkurtit 2017, paditësit kishin sjellë si provë një certifikatë të vendbanimit të Nushe Loxhaj-Bicaj, në të cilën evidentohet se ajo banon në fshatin Banjë të Istogut. Gjatë së njëjtës seancë, e paditura kishte kërkuar përjashtimin e gjykatësit Demiraj nga gjykimi i këtij rasti me pretendimin për njëanshmëri. Mirëpo, kërkesa në fjalë ishte refuzuar nga kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, Kreshnik Radoniqi, me pretendimin se pala e paditur, kërkesën lidhur me çështjen e kompetencës është dashur ta kërkojë më së largu deri në momentin e përgjigjes në padi, të cilën gjë sipas tij, nuk e ka bërë e paditura. Pasi ishin refuzuar këto kërkesa dhe procesi do të mund të vazhdohej me shqyrtim, në seancën e 28 marsit të vitit 2017, pas propozimeve të palëve, gjykata kishte vendosur që seancën gjyqësore ta caktojë për 8 maj 2017, në mënyrë që t’i dëgjojë ekspertët e angazhuar për zbardhjen e këtij rasti. Në atë seancë ishte paraparë që në pjesën e paradites të dëgjohej eksperti rrugor dhe ai i arkitekturës, ndërsa në pjesën e pasdites ekspertët mjeko-ligjorë.

Megjithatë seancë në fjalë nuk ishte mbajtur, kjo për shkak se gjykatësi Daut Demiraj, kishte ndërprerë procedurën në këtë lëndë, pasi pala e paditur, “Kosova e Re”, e kishte njoftuar atë se tashmë kishte filluar një hetim ndaj bashkëshortit të Nushe Loxhaj -Bicaj, Xhavit Bicaj, që ishte njëri nga paditësit, me pretendimin se ka kryer disa vepra penale, të cilat ndërlidhen me rastin kontestues që gjykohej nga ai. Për ta marr një vendim të tillë, gjykatësit Demiraj i kishte mjaftuar

njoftimi nga pala e paditur, pa kërkuar asnjë informacion nga instancat tjera, nëse një gjë e tillë ishte e vërtetë.

Sidoqoftë, ndaj këtij vendimi, pala paditëse kishte ushtruar ankesë në shkallën e dytë, me ç'rast Gjykata e Apelit, më 18 prill 2018, e kishte konsideruar me shkelje të dispozitave ligjore vendimin e shkallës së parë dhe kishte kërkuar nga gjykatësi që të bëjë verifikimin e kushteve për të thirrur seancë përgatitore ose shqyrtim kryesor të çështjes, pas të cilit, sipas tyre, do të merrej një vendim i ligjshëm. Sipas instancës së dytë, gjykatësi nuk është siguruar fare nëse për këtë rast ka apo jo një aktvendim për fillimin e hetimeve.

Ky rast ishte trajtuar edhe nga emisioni “Betimi për Drejtësi”, në të cilin emision ishte gjetur se kallëzimin penal për të cilin ishte pezulluar procedura e kishte parashtruar vetë pala e paditur, derisa në këtë rast, ende nuk kishin filluar hetimet, përkatësisht nuk kishte aktvendim për fillimin e hetimeve. Për më tepër, Gjykata as pas kthimit të këtij rasti nga Gjykata e Apelit nuk kishte caktuar seancën. Kjo ishte bërë vetëm pas publikimit të hulumtimit në emisionin “Betimi për Drejtësi”. Pas këtij hulumtimi, gjykatësi Demiraj kishte bërë kërkesë te kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, Kreshnik Radoniqi, që të përjashtohet nga kjo çështje penale, me arsyetimin e mënjanimin të çfarëdo rrethane që mund të vejë në dyshim paanësinë e gjykatës dhe ruajtjen e objektivitetit në vendimmarrje. Në këto rrethana, kjo lëndë i është ndarë gjykatësit Shemsedin Haxhijaj.

Edhe pse gjykatësi Haxhijaj kishte mbajtur dy seanca gjyqësore, më 21 dhjetor 2018 dhe më 25 janar 2019, ky rast kishte mbetur pezull për shkak se gjykata kishte qenë në pritje të një super ekspertize të komunikacionit, e cila është dashur të përgatitet nga profesorët e Fakultetit Teknik, të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”. Edhe në këtë fazë, ky rast ishte zvarritur, dhe procedura kishte rifilluar vetëm pasi “Betimi për Drejtësi” kishte hulumtuar për herë të dytë këtë rast.

Në këtë rast, Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Istog, me 14 tetor 2019, ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesë padisë e paditëses Nushe Logjaj- Bicaj, duke e detyruar të paditurën Kompaninë e Sigurimeve “Kosova e Re”, që në emër të kompensimit të dëmit për aksidentin e 27 janarit 2016, për dëme jo materiale të paguajë 100,500.00 euro. Ndërsa për paditësit Xhavit, Liridon dhe Arian Bicaj, gjykata e ka detyruar të paditurën që në emër të dëmit jo-material për dhimbje shpirtërore për invalidët secilit nga 4,000.00, gjithsej në shumë prej 12,000.00. Kjo gjykatë e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar kërkesë padinë e paditëses Loxhaj-Bicaj, për dëmin materiale

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Ky rast është përshkruar me zvarritje të vazhdueshme nga Gjykata pothuajse në secilën fazë.

Por, zvarritja më e madhe në këtë rast është bërë me rastin e pezullimit të procedurës. Kjo zvarritje, tërheq pas vetes shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe cënim të sigurisë juridike të qytetarëve.

Fillimisht, Gjykata Kushtetuese në një rast kishte vendosur se pezullimi i pacaktuar i procedurës është privim nga realizimi i të drejtave të caktuara dhe si rrjedhojë me pezullimin e procedurës civile në këtë formë shkelet nenit 31 (2) i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së. Ky aktgjykim është nxjerrë para se Gjyqtari Daut Demiraj të pezullonte procedurën civile në këtë rast. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës²¹,”

Ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës është i publikuar në Gazetën Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, Gjyqtari i rastit është dashur që aktgjykimin në fjalë ta respektoj në rastin konkret, dhe jo të nxjerrë një vendim që për pasojë ka pasur zvarritjen e këtij rasti. Ndër të tjera, Gjyqtari duhet të mbrojë palët nga kërkesat e palëve të pabazuara në ligj. Në të kundërtën, gjyqtari do të kalojë në arbitraritet, i cili më së paku është funksion i një gjyqtari.

Në anën tjetër, procedura në këtë rast ishte pezulluar për faktin e vetëm se ndaj paditësit, nga i padituri, ishte parashtruar një dokument i cili thjesht mban vulën e prokurorisë, i cili dokument quhet kallëzim penal. Në këtë kallëzim penal, Prokuroria nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim sipas të cilit do të dihej së paku se ky kallëzim penal a paraqet ndonjë lloj dyshimi. Por, mbi bazën e këtij kallëzimi penal, Gjyqtari ka pezulluar procedurën.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se është cenim i pastër i sigurisë juridike persekutimi i qytetarëve, në rastin konkret pezullimi dhe zvarritja e procedurës civile për faktin se dikush ka parashtruar një kallëzim penal, i cili si i vetëm, sipas ligjit, nuk paraqet asgjë. Për këtë arsye, Gjyqtarët duhet të jenë të kujdesshëm që raste të tilla mos të ndodhin në të ardhmen, derisa asnjë prej këtyre rasteve KGJK nuk duhet ta kaloj symbyllurazi.

²¹Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 116.

4. Sfida e sistemit gjyqësor për të konstatuar nëse rasti është “çështje e gjykuar”

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës:C.nr.190/17

Paditës: Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog

I Paditur: Sadri Nicaj

Data e paraqitjes së padisë: 5 janar 2006

Kontesti: Lirim nga Patundëshmëria

Para 13 vitesh Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog kishte nisur betejën ligjore përmes ushtrimit të padisë në ish-Gjykatën Komunale të Istogut ndaj të paditurës Have Nicaj, duke kërkuar që e paditura të liroj hapsirën dy dhomëshe, të cilën sipas paditëses e paditura e kishte uzurpuar.

Kjo paluajtshmëri në të cilën po kërkohet lirimi i saj, sipas Shoqatës së të Verbërve, është në funksion të pushimores të personave të verbër e që mbi 35 vite ishte uzurpuar nga e paditura Have Nicaj, ndërsa pas vdekjes së saj, në cilësinë e të paditurit është përfshirë Sadri Nicaj.

Në këtë rast, nga Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e shkallës së dytë janë marrë më shumë se pasë vendime gjyqësore.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit Fillimisht ish-Gjykata Komunale në Istog më 19 qershor 2006, kishte hedhur poshtë padinë e Shoqatës së të Verbërve për shkak se kishte vlerësuar se ishte çështje e gjykuar.

Si të paligjshëm dhe në shkelje të procedurës kontestimore këtë vendim gjyqësor të Gjykatës së Istogut e kishte cilësuar ish-Gjykata e Qarkut, e cila më 5 shkurt 2007 kishte anuluar vendimin e mësipërm.

Gjykata e Qarkut kishte arsyetuar se gjykata e shkallës së parë kishte gabuar kur kishte konstatuar se rasti kontestimor i Shoqatës ishte i gjykuar.

Pasi çështja kontestimore ishte kthyer në rivendosje, më 11 mars 2008 ish-Gjykata e Qarkut kishte aprovuar pjesërisht padinë e Shoqatës së të Verbërve duke vërtetuar se janë pronarë të paluajtshmërisë - ngastrës ngadastrale 4/82 me kulturë shtëpi dhe oborr me sipërfaqe prej 0.5 hektar, mirëpo kishte refuzuar kërkesën e Shoqatës që e paditura Have Nicaj t’ia lirojë katin e dytë të shtëpisë, në të cilën si pronare evidentohet Shoqata e të Verbërve. Ky vendim përsëri ishte prishur nga ish-Gjykata e Qarkut më 21 maj 2009.

Kjo gjykatë kishte arsyetuar se aktgjykimi i ish-Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë dhe i ligjshëm për shkak se paditëses i’u është njohur e drejta e pronësisë, mirëpo përkundër kësaj është refuzuar që e njëjta t’i dorëzohet në posedim.

Ndërsa, përsëri ish-Gjykata Komunalë në Istog më 27 tetor 2011 kishte hudhur padinë e Shoqatës së të Verbërve si të palejuar, duke arsyetuar se ishte çështje e gjykuar.

Ankesë kundër këtij aktvendimi kishte ushtruar paditësja, e cila kishte kërkuar nga gjykata e shkallës së dytë të të anulojë këtë vendim për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Duke vepruar në bazë të kësaj ankesë, ish-Gjykata e Qarkut kishte refuzuar ankesën e Shoqatës së të Verbërve si të pabazuar dhe kishte vërtetuar aktvendimin e ish-Gjykatës Komunale në Istog. Por, këtë aktgjykim më 24 dhjetor 2013 e kishte prishur Gjykata Supreme, sipas të cilësaktgjykimi në fjalë ishte mbështetur në aktvendime jo të plotëfuqishme dhe si tilla cilësohen inekzistente.

Pasi rasti ishte kthyer në rigjykimin, ish Gjykata Komunale në Istog përsëri kishte vendosur që të hudhë padinë e paditësës si të palejuar pasi sipas kësaj Gjykatë për këtë çështje ishte vendosur me vendim të formës së prerë nga po e njëjta Gjykatë.

Pas këtij vendimi, tashmë i pesti me radhë, kjo çështje kontestimore ishte deleguar në Gjykatën Themelore në Pejë, me kërkesën e Shoqatës Komunale të të Verbërve e cila tani gjendet në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Në këtë rast, Shoqata Komunale e të Verbërve në Istog është privuar nga e drejta e tyre që rasti i tyre të marrë epilog brenda një kohe të arsyeshme.

Por, kjo nuk ka ndodhur për arsye objektive, përkatësisht për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe numrit të vogël të gjyqtarëve, por për shkak se për të njëjtën çështje, asnjë shkallë e gjyqësorit nuk ka mundur të vendosë.

Në këtë rast, lënda më së shpeshti është kthyer në rigjykim për shkak të dilemave të hallkave gjyqësore lidhur me definimin e “çështjes së gjykuar” në rastin konkret. Po ashtu, një nga vendimet ishte prishur pasi Gjykata nuk kishte arritur që të përcaktonte legjitimacioni aktiv, përkatësisht faktin se kush është palë në procedurë.

Lidhur me këtë situatë, IKD vlerëson se për pothuajse të gjitha çështjet është normale që të ketë dilema në gjyqësor. Por, këto dilema nuk duhet të mbesin të pazgjidhura në mes të gjyqësorit dhe në dëm të interesave të qytetarëve. Për të qartësuar këto çështja, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ka përcaktuar hierarki në sistemin gjyqësor, Në këtë mënyrë, edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk duhet që thjesht të konstatojnë gabimet dhe rastet ti kthejnë në rigjykim, por duhet të vendosin standarde dhe të qartësojnë dilema. Nëse pas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit gjykatat e shkallës së parë nuk veprojnë në këtë mënyrë, atëherë është përgjegjësi e KGJK-së që të veprojnë sipas ashtu siç kërkohet me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

5. Ndërprerja e procedurës kontestimore në kontestin për vërtetimin e së drejtës së pronësisë.

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës:C.nr.255/12

Paditës:Misin, Dash, Iliaz dhe Xhafer Gashi

I Paditur: Sadri Smajl Berisha

Data e paraqitjes së padisë:05/09/1996

Kontesti: Vërtetim Pronësie dhe Lirim nga Patundëshmëria

Gjykata Themelore në Pejë, ishte duke u zhvilluar një kontest për vërtetimin e së drejtës së pronësisë dhe kthim të paluajtshmërisë nga padia e paraqitur nga paditësit Misin, Dash, Iliaz dhe Xhafer Gashi në Gjykatë në vitin 1996 kundër të paditurit Sadri Berisha.

Gjykata Themelore në Pejë më 10 maj 2018, ka marrë aktvendim me të cilin e ka ndërprerë këtë çështje kontestimore, pasi që i padituri ka ndërruar jetë dhe ende nuk është zhvilluar procedura trashëgimore për të konstatuar trashëgimtarët e të paditurit.

Në aktvendim theksohet se procedura kontestimore në këtë çështje civile do të vazhdohet pasi të përfundojë procedura trashëgimore dhe të përcaktohen trashëgimtarët e të paditurit.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

IKD gjen se në këtë rast ende nuk është arritur që të vazhdohet procedura kontestimoreqysh nga maji i vitit 2018 ,për shkak se ende nuk është zhvilluar procedura e trashëgimisë nga pasardhësit e të paditurit.

Kjo çështje kontestimore po mbetet “ngrirë” për më tepër se një vit ,për shkak të mos zhvillimit të procedurës së trashëgimisë, edhe pse në anën tjetër bazuar në Ligjin për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata në të cilën po zhvillohet procedura kontestimore ka autorizim ligjor të zgjidhë procedurën e trashëgimisë dhe të caktoj trashëgimtarët ligjor me qëllim që të vazhdoj procedurën e vërtetimit të pronësisë, në mënyrë që të mos bëhen vonesa për palët në procedurë.

Lënda civile po mbetet pezull vetëm për shkak të moszbatimit të një dispozite të vetme ligjore nga ana e Gjykatës Themelore të Pejës, e që është ajo e zgjidhjes së “çështjes paraprake”.

Ligji për Procedurën Kontestimore në paragrafin 1 të nenit 13 theksohet se “*Kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike, e lidhur me të ende nuk ka marrë vendim, gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja*

paraprake), atëherë gjykata ka tagër që vetë ta zgjidhë çështjen e tillë, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe. Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në procedimin në të cilin është zgjidhur çështja e këtillë”.

Kurse Ligjir për Procedurën Jokontestimore precizon se “*Procedura për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore vihet në veprim nga gjykata sipas detyrës zyrtare posa gjykata të informohet se një person ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjyqësor”.*

Për këtë arsye, IKD vlerëson se Gjykata në këtë rast duhet që të zbatojë të gjitha kompetencat e saja, në mënyrë që për qytetarët e Republikës së Kosovës të sigurojë një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht faktit se çfarë vendimi merret në rastin konkret. Në këtë mënyrë, si në këtë por edhe në raste të tjera, Gjykatat nuk duhet të krijojnë praktika të kundërligjshme, për shkak të të cilave dëmtohen interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

6. Procesi gjyqësor gati dy dekadësh, ku paditësi e konteston pronën në të cilën jeton i paditur Ministri i FSK Rustem Berisha

Gjykata Themelore në Pejë

Nr i lëndës: C.nr.771/17

Paditës: Ibrahim Fazliu

I paditur: Rustem Berisha dhe Komuna e Pejës

Data e paraqitjes së padisë: 11/10/2000

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Paditësi Ibrahim Fazliu në vitin 2000 ka paditur ish-Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Rustem Berisha dhe Komunën e Pejës sepse pretendon se kundërligjshëm i është marrë e drejta e shfrytëzimit të pronës në Pejë, me sipërfaqe prej mbi katër ari dhe i është bartur ish-komandantit të UÇK-së dhe ish-ministrit të FSK-së.

Sipas tij, Kuvendi Komunal i Pejës, më 12 nëntor të vitit 1999, kishte marr vendim që këtë pronë t'ia jep në shfrytëzim të përhershëm Berishës dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasuri private, e cila si e tillë në asnjë mënyrë, nuk ka mundur të jepet në shfrytëzim nga Komuna e Pejës të paditurit Berisha.

Për këtë çështje juridiko-civile, padia e parë ndaj të paditurve të njëjtë, është ushtruar në vitin 2000, për të njëjtën bazë juridike, nga Hysen Fazliu, vëllai i tani paditësit, Ibrahim Fazliu. Sa i përket kësaj kërkesë, dy herë është vendosur nga gjykatat në nivel të shkallës së parë dhe të dytë.

Lidhur me padinë e parë, më 19 shtator 2001, ish-Gjykata Komunale në Pejë, nxori aktvendim me të cilin e kishte aprovuar propozimin e të paditurit Rustem Berisha, për ndërprerjen e procedurës kontestimore. Ndër të tjera, ish-Gjykata Komunale, ndërprerjen e procedurës e kishte arsyetuar për faktin se mes palëve ndërgjyqëse ishte paraqitur si kontestues, vlefshmëria e aktit të trashëgimisë dhe për këtë çështje vendoset në procedurë jokontestimore.

Kundër këtij aktvendimi, për ndërprerjen e procedurës kontestimore, kishte paraqitur ankesë nga paditësi, e cila ishte aprovuar nga ish-Gjykata e Qarkut.

Vendimi tjetër i radhës, në të cilën gjykata kishte vlerësuar themelësinë e kërkesëpadisë, ishte më 9 maj 2002, me të cilin aktgjykim ishte refuzuar kërkesëpadia e paditësit Hysen Fazliu, me të cilin kërkonte të vërtetohet se është pronar i patundshmërisë nr.5390/23.

Ish-Gjykata Komunale në Pejë, me vendim e saj, paditësit nuk ia kishte njohur të drejtën e pronësisë në bazë aktvendimit mbi trashëgimi, ngase, sipas gjykatës, ky vendim nuk i plotëson as për së afërmi formën e paraparë procedurale për shqyrtimin e trashëgimisë.

Ky aktgjykim, pas së cilës ankesëish-Gjykata e Qarkut në Pejë, me aktvendimin e saj më 11 janar 2006 prishi aktgjykimin e shkallës së parë, duke e kthyer në rishqyrtim.

Gjykata Themelore në Pejë më 2 korrik 2017, kishte marr aktvendim, me të cilën kishte hedhur poshtë padinë e paditësit Ibrahim Fazliu si të parregullt. Kjo pasisipas gjykatës së shkallës së parë, paditësi Fazliu kishte dhënë adresë e të paditurit të parë, por sipas fletëkthesës së kthyer kishte rezultuar nga postierit se “pala jeton në Prishtinë”.

Në bazë të kësaj, Gjykata merr vendim sipas të cilit paditësit i’ a kthen padinë për korrigjim, duke e detyruar që në afat prej tre ditësh, të potencojë adresën e saktë të paditurit Rustem Berisha. Kurse, paditësi, sipas Gjykatës, si adresë të vendbanimit, prapë, kishte paraqitur adresën e parë , të cilën e kishte theksuar në padi. Si pasojë e kësaj, Gjykata kishte hedhur padinë.

Kundër këtij aktvendimi, është ushtruar ankesë nga paditësi, ku Gjykata e Apelit, më 13 korrik 2017, kishte prishur vendimin e shkallës së parë, duke e kthyer në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit ka theksuar se gjykata e shkallës së parë, pas dorëzimit të parashtresës për plotësim të padisë, nuk ka provuar që të njëjtën t’ia dorëzojë të paditurit Rustem Berisha, pavarësisht, së është prezantuar adresa e njëjtë.

Gjatë monitorimit sistematik të kësaj seancë, IKD ka analizuar dhe vlerësuar rrjedhjen procedurale dhe materiale të këtij rasti dhe respektimin e afateve ligjore nga ana e gjykatës dhe si rrjedhjesë IKD ka gjetur se procedura civile në rastin ku i paditur është ish- ministri i FSK-së manifestohet me zvarritje të theksuara të procedurës. Në këtë rast Gjykata e Pejës nuk ka marrë asnjë masë efektive për të parandaluar këtë prolongim të procedurës si në rastin konkret kur Komuna e Pejës është urdhëruar dyherë nga Gjykata t’ a sjellë dokumentacionin përkatës me të cilën do të vlerësohej nëse Komuna e Pejës ka përfillur procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim të tokës kontestuese.

Mirëpo ky urdhër i gjykatës nuk është marrë parasyshtë nga Komuna e Pejës dhe e njëjta nuk ka siguruar shkresat për të cilat është detyruar nga gjykata, ndërsa gjykata në anën tjetër nuk ka marrë asnjë masë ligjore ndaj palëve në procedurë për të ndaluar çdo keqpërdorim të drejtave në procedurë të cilat ndikojnë në shkaktimin e vonesave dhe tejzgjatje të procedurave.

Kur caktohen seancat gjyqësore në rastin ndaj ish- ministrit Berisha, ato caktohen afërsisht pas më shumë se 3 muajsh, ndërsa gjykata asnjëherë nuk e arsyeton faktin se përse seancat po caktohen pas 3 muajve e jo në afat prej 1 muaji siç parasheh ligji.

IKD ka gjetur se seanca 5 nëntorit 2018 është caktuar me 21 nëntor 2018 pas 3 muajve e 9 ditë. Seanca e 21 nëntor 2018 është caktuar më 24 janar 2019 gjegjësisht pas 4 muaj e 4 ditë. Seanca e 24 janar 2019 është caktuar më 14 mars 2019 pas 1 muaj e 19 ditësh kurse prej 14 mars 2019 ende deri më tani nuk është arritur të mbahet asnjë seancë.

7. Gjykata e Prishtinës e gjykon në afat rekord kontestin e Ish-Shefi i Krimeve Ekonomike Nazim Sahiti për t'u kthyer në vendin e tij të punës.

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr i lëndës:3586/18

Paditës:Nazim Sahiti

I paditur: Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Kosovës.

Data e paraqitjes së padisë: 7/12/2018

Kontesi: Kthim në vendin e punës

Në këtë rast, Paditësi Nazim Sahiti, sipas padisë së ushtruar më 7 dhjetor 2018, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, që ta anulojë vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, me të cilin ai ishte shkarkuar nga pozita e drejtorit të Drejtorisë së Hetimeve të Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit në Policinë e Kosovës, duke kërkuar gjithashtu që të kthehen në vendin e tij të punës.

Për të arritur deri tek përfundimi i kësaj rasti, Gjykata Themelore në Prishtinë ka mbajtur vetëm dy seanca gjyqësore, të cilat që të dyja ishin caktuar brenda muajit mars 2019, atë më 6 mars dhe 25 mars 2019. Ndërsa pas përfundimit të kontestit më 25 mars 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë pas 18 ditëve ka marrë vendim me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Nazim Sahiti dhe e ka kthyer në vendin e tij të mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Ndaj këtij vendimi, Policia e Kosovës ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila ende nuk ka vendosur në këtë rast.

IKD vlerëson dhe vazhdimisht kërkon që rastet të trajtohen në kohë të arsyeshme, mirëpret kur rastet përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm si në rastin konkret, duke pasur parasysh mënyrën se si funksionon sistemi gjyqësor në Kosovë, atëherë kemi të bëjmë me trajtim selektiv. Kjo për arsye se janë një numër jashtëzakonisht i madh i lëndëve, prej tyre edhe lëndë me prioritet, të cilat nuk zgjidhen për vite nga gjyqësori i Kosovës, derisa në këtë rast është vepruar me urgjencë. Në këtë mënyrë, secili qytetar i Republikës së Kosovës, i cili për rastin e tij ka pritur me vite gjyqësorin, këtë rast e sheh si trajtim selektiv nga Gjykata, i cili fakt ndikon në uljen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës.

8. Administrimi jo efikas i drejtësisë nga Gjykata Themelore në Prishtinë në rastin e 17 paditësve të cilët kërkuan të kthen në vendin e punës.

Gjykata Themelore në Prishtinë

Nr i lëndës: C.nr.3243/14

Paditës: Sadri Gashi, Naser Metolli, Qamil Maqedonci etj.

I paditur: Ndërmarrja shoqërore “Victory”

Data e paraqitjes së padisë: 2/12/2014

Kontesti: Kthim në vendin e punës

Ish 17 punëtorët e Hotel “Victory” Sadri Gashi, Naser Metolli, Qamil Maqedonci, Qamil Morina, Fehmi Ismajli, Ahmet Kokolli, Afrim Qyqalla, Ardian Gashi, Florim Shala, Driton Rexha, Granit Mehmeti, Fatlum Jashari, Qamil Bllaca, Valon Arifi, Arsim Zejnullahu, Nuhi Ejupi dhe Ismet Metolli, më 31 gusht 2014 ishin larguar nga puna.

Ndaj këtij vendimi, të njëjtit më 2 mars 2017 kishin paraqitur padi në Gykatën Themelore të Prishtinës. Sipas padisë, largimi nga puna ishte bërë me urdhër verbal të pronarit të NSH “Victory”, Blerim Vitija, i cili në mënyrë të njëanshme iu kishte ndërprerë marrëdhënien e punës pa kurrfarë sqarimi.

Më 4 dhjetor të vitit 2014, gjykata kishte marrë në trajtim rastin e tyre me ç’rast ishin mbajtur 10 seanca gjyqësore. Këto seanca gjyqësore vazhduan të mbahen duke thirrë dëshmitarë dhe ekspertë deri më 10 qershor 2018 kur gjyqtarja e rastit, kishte marrë vendin për hudhjen poshtë të padisë duke e cilësuar të njëjtën si të pasafatshme.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

IKD vlerëson se trajtimi i rastit të ish-punëtorëve nuk ishte bërë në përputhje me Ligjin për Procedurën Kontestimore, respektivisht nuk ishte trajtuar në harmoni me parimin e efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës kontestimore.

Fakti se Gjykata Themelore në Prishtinë ka mbajtur 10 seanca gjyqësore duke ndëgjuar dëshmitarë dhe duke thirrë ekspert në shqyrtim gjyqësor, kjo tregon se gjykata ka anashkaluar fazën e parë të analizimit dhe shqyrtimit paraprak të padisë e cila është fazë fillestare në të cilën vlerësohen padia e palëve nëse ajo është e rregullt në aspektin në procedural dhe material.

Çëshja e vlerësimit të afatshmërisë së kërkesëpadisë duhet të realizohet në fazën paraprake të shqyrtimit të padisë dhe kjo fazë mundëson që një proces gjyqësor të administrohet pa vonesa dhe vetëm paditë të cilat janë të rregullta ligjërisht të procedohen në shqyrtim gjyqësor.

Për shkak të mënyrës së tillë të veprimit, në Gjykatë janë mbajtur një numër i madh i seancave, ndonëse sipas gjykatës, kërkesa kishte qenë e pasafatshme.

IKD vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me administrim jo të mirë të drejtësisë. Në pothuajse secilën procedurë gjyqësore, parimi i ekonomizimit të procedurës si parim i përgjithshëm sendërtohet me dispozita të veçanta, që mundësojnë zbatimin në praktikë të këtij parimi. Në rastin konkret, si dispozitë e veçantë është rregulli për shqyrtimin paraprak të padisë, filter ky i cili në rastin konkret ka dështuar të zbatohet nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

9. Rekomandimet:

1. Sistemi gjyqësor të angazhohet maksimalisht që lëndët civile të kryhen brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në këtë drejtim, KGJK duhet të kuptojë faktin se zvarritja e lëndëve me dekada cenon rëndë të drejtat dhe liritë e qytetarëve për të pasur një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor;
2. Zvarritja e trajtimit të lëndëve nëpër gjykata e humb besimin e publikut në sistemin gjyqësor si dhe shërben si faktor kriminogjen që qytetarët të marrin drejtësinë në duart e tyre, andaj duhet të ndërmarr masa urgjente në evitimin e situatave të tilla.
3. KGJK të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së Divizioneve Civile me lëndë, në mënyrë që të ketë mundësi të ndërmarrë hapa për stabilizimin e këtyre divizioneve, veçanërisht sa i përket lëndëve të cilat barten vit pas viti.
4. KGJK të ri analizojë rregulloren mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit të secilit gjyqtar.
5. KGJK duhet të ngritë llogaridhënien e gjykatësve para KGJK-së dhe mekanizmave të saj si Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjykatësve lidhur me performancën nën nivelin e politikave të miratuara nga KGJK për trajtimin e lëndëve civile.
6. KGJK dhe Kryetarët e Gjykatave të ndërmarrin masa ndaj gjyqtarëve, të cilët nuk respektojnë afatet ligjore në trajtimin e rasteve civile. Në këtë drejtim, KGJK duhet ta ketë të qartë se raportet e saja periodike shërbejnë për informim të publikut dhe për t'i mundësuar këtyre institucioneve ndërmarrjen e masave konkrete për të sanuar pasojat, dhe jo vetëm për evidentimin statistikor të fakteve.
7. Gjykatësit e Gjykatës së Apelit të evitojnë praktikat që të njejtat lëndë t'i kthejnë në rigjykim disa herë.
8. KGJK përmes vlerësimit të performancës të vlerësoj performancën e gjykatësve aktgjykimet e të cilëve kthehen disa herë në rigjykim.
9. Gjykatat të trajtojnë lëndët sipas radhës, përpos rasteve kur prioriteti ipet me ligj, dhe jo të kenë qasje selektive. Gjykatësit që shkelin këto prioritete të ligjit dhe politikave të KGJK-së të mbahen përgjegjës.
10. Gjyqtarët në kuptim të zbatimit të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të zbatojnë jurisprudencën dhe standardet e GjEDNj-së.
11. Gjyqtarët të ndalin praktikat e pezullimit të lëndëve pa bazë ligjore.
12. Gjykatat të trajtojnë me prioriteti më të madh lëndët që janë duke pritur me dekada. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore e Pejës duhet të trajtojë me prioritet rastin e 51 padisë së qytetarit ndaj AKP-së, në të cilin rast edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka konstatuar shkelje.